

Pejgamberi i Mëshirës dhe Ne

Osman Nuri Topbash



Shkodër / 2021

TITULLI ORIGJINAL
- Mülâkat -
Rahmet Peygamberi ve Biz

PËRKTHEU
Alban Kali

REDAKTOI
Ilir Hoxha

FAQOSJA
Bledar Xama

BOTIMI I
Prill 2021, Shkodër

PROGRESI BOTIME
Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182

Pejgamberi i Mëshirës dhe Ne

Osman Nuri TOPBASH





PREZANTIM

Mëshira e botëve, Zotëria ynë, Resulullahu ﷺ...

I Dërguari i Allahut, në gjurmët e të cilit ecin shekujt.

Kushti i domosdoshëm i dëshmimit të shehadetit.

I pari në robëri...

Prijësi i dy botëve...

Shembulli më i mirë.

Litari i shpëtimit i dërguar me mëshirën dhe rahmetin e Zotit.

Profeti më bujar... Profeti më i nderuar...

Mbreti i profetëve... Referenca e të diturve...

Më i dashuri i Zotit... Ndërmjetësuesi i Ditës së Mbrame...

Drita e rrugës sonë...

Udhërrëfyesi i Xhenetit...

Lideri i falënderuesve...

Tek ai mbahemi.

Atëherë;

Të qenit umet i tij...

Të qenit vëlla me të…

Të merituarit e të qenit së bashku me të…

Bindja ndaj tij…

Përbëjnë edhe përgjegjësitë tona më emergjente.

Ky libër modest i vjen shpirtërave tanë me shijën e ëmbël të bashkëbisedimit në klimën e dashurisë së të nderuarit tonë Osman Nuri Topbashit ndaj Resulullahut ﷺ. Hyni edhe ju në këtë klimë dashurie dhe do të përjetoni thellësisht me zemër hadithin: **"Njeriu është me atë që do."**

Le ta duam atë ﷺ, që Allahu të na e dhurojë mirësinë e të qenit bashkë me të në Dynja e në Ahiret…

Amin!..

Ahmet TASHGETIREN



PARAFJALË

Falënderime të pafundme për Allahun e Lartmadhëruar që na nderoi ne, robërit e Tij nevojtar, me mirësinë e robërisë ndaj Tij, e na përmbushi duke na bërë pjesë të umetit të Profetit më të lartë.

Salatet dhe selamet qofshin për Krenarinë e gjithësisë, Mbretin e zemrave, i cili ftoi njerëzimin ajet pas ajeti, sure pas sureje, me Fjalën e Allahut, Kuranin famëlartë, që është harta e lumturisë së njeriut, e kështu u bë shkak që ata të nderohen me dritën e besimit, diturisë dhe urtësisë.

Resulullahu ﷺ është shembulli i vetëm për të gjitha nivelet njerëzore, nga më i ulti e deri tek më i larti...

Këtë të vërtetë Allahu i Lartmadhëruar e ka shpallur kështu:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِى رَسُولِ اللهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ
لِمَنْ كَانَ يَرْجُوا اللهَ وَالْيَوْمَ الْاٰخِرَ وَذَكَرَ اللهَ كَثِيرًا

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."
(Ahzab, 21)

Teksa në ajetin e mësipërm na prezantohet Resulullahu si shembulli më i përsosur, nuk theksohet apo veçohet ndonjë cilësi apo specifikë e tij, dhe nga kjo duhet të kuptojmë faktin që jeta e tij është shembulli më i bukur në çdo kohë e veprim.

Kështu pra njerëzimi;

Dimensionin shpirtnor të adhurimeve duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Delikatesën duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Normat e moralit duhet t'i mësojë nga ai ﷺ...

Butësinë duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Oratorinë duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Edukimin duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Thellësinë e shikimit duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Meditimin dhe leximin e vëmendshëm të universit duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Bujarinë duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Mëshirën ndaj jetimit dhe nevojtarit duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Qëndrimin afër të vetmuarve duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Respektin ndaj më të rriturve duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Dhembshurinë ndaj më të vegjëlve duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Drejtësinë duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Moralin e bukur duhet ta mësojë nga ai ﷺ...

Me shprehjen që Resulullahu ﷺ ka thënë në lidhje me veten:

"Mua më edukoi Zoti. Sa edukim të përsosur më dha Ai!" (Sujuti, I, 12.), kuptojmë qartazi se Profeti ka kaluar në një proces të mirëfilltë edukimi hyjnor e më pas i është dhuruar të gjithë njerëzimit si modeli me i përsosur.

Ai u sprovua me fatkeqësitë më të mëdha që mund t'i bien njeriut, por nuk e humbi mbështetjen dhe dorëzimin te Allahu i Lartmadhëruar.


Ai u godit me gurë, por nuk mallkoi keqbërësit. Përkundrazi u lut për pasardhësit e tyre që ata të udhëzohen e t'i shërbejnë Islamit.

Edhe pse përjetoi vuajtje e situata shumë të rënda, nuk e humbi durimin dhe nuk e braktisi falënderimin, duke qëndruar në lartësinë maksimale të figurës së tij shembullore.

U dhunua dhe u fye tmerrësisht nga idhujtarët, por nuk hoqi dorë nga misioni i tij profetik, duke u strehuar tek Allahu ﷻ e duke iu dorëzuar Atij.

Asnjëherë nuk u kaplua nga mendjemadhësia. Përkundrazi jetoi krejtësisht në mënyrë modeste. Ai thoshte vazhdimisht: *"Ti o Zoti im! Mirësia Jote... bujaria Jote..."*

Bota e tij e brendshme ishte ndaj çdo krijese më e butë se pambuku. Ishte një oqean mëshire. Edhe në rastet kur ai për vete ishte në nevojë, mendonte për umetin duke vendosur të tjerët para vetes. Ai



shpërndante çfarë kishte në zotërim. Kënaqësia e qerasjes së tjetrit, ia shuante urinë e etjen.

Në një hadith, Resulullahu ﷺ shprehet:

"Unë jam më afër e më para besimtarit se vetvetja e tij. Kur dikush vdes duke lënë pasuri, ajo i takon të afërmve të tij. Por nëse ai lë borxhe dhe jetimë prapa, ai borxh është i imi dhe përkujdesja ndaj jetimëve është detyra ime." (Muslim, Xhuma, 43.)

Tasavvufi është edukimi që synon gdhendjen e kësaj bote të bukur profetike në zemrën tonë.

Çfarë i takon të bëjë besimtarit, është përpjekja për ta ndjekur në çdo çast, siç ndjek hija të zotin e saj, Resulullahun ﷺ, të vetmin burim mëshire që e shpie atë drejt dashurisë hyjnore. Kjo përpjekje do të na ndihmojë të fitojmë knaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Në një ajet kuranor thuhet:

قُلْ اِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللّٰهَ فَاتَّبِعُونِى يُحْبِبْكُمُ اللّٰهُ
وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللّٰهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

"Thuaju (o Muhamed)**: Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë."** (Âl 'Imran, 31)

Standardi i vetëm i dashurisë hyjnore është bindja ndaj Resulullahut, lidhja me të, të shërbyerit

atij. Në të kundërt imani e humbet forcën e vet. Asnjë njeri nuk mund ta fitojë kënaqësinë e Allahut në mënyra të tjera. Ai që nuk fiton dot kënaqësinë e Allahut, i bën kot veprat e tjera. Në Kuran thuhet:

عَامِلَةٌ نَاصِبَةٌ

"...që kanë punuar e janë rraskapitur (duke bërë të këqija në këtë botë)**."** (Gashije, 3)

Prandaj themi që në qendrën tonë të jetës dhe të zemrës duhet të jetë i pranishëm Resulullahu ﷺ. Personaliteti i tij shembullor duhet të jetë arkitekti i vetëm i karakterit tonë.

Për t'ia dalë në krye kësaj, pra njohjes së Profetit më nga afër, kemi nevojë, më shumë se për gjithçka, për një jetë që jetohet me devocion dhe duke kryer vepra të mira... Ashtu siç bënë sahabët... Derisa rrahjet tona të zemrës të bashkohen me të... Si ashikët e përmalluar të pejgamberëve...

Sepse dashuria e tyre për Resulullahun, i kishte eliminuar dashuritë e tjera tokësore në zemrat e tyre. Përgjigjja me shumë dashuri e sakrificë që i kthehej çdo kërkese të tij, ishte: "T'u bëfshim kurban me çfarë kemi, o Resulullah!" Gjithashtu atë sakrificë që bënin, e shihnin si privilegj e mirësi.

Edhe nëse për ne, që jemi me plot mangësi, niveli i dashurisë që ai ﷺ meriton është i pamundur, të qenit në rrugën e dashurisë së tij është fat i madh. Të përvetësuarit qoftë edhe të një pjese të

vogël të personalitetit të tij, është shkak për fitimin e përjetësisë.

Të dashur lexues!

Në dhjetorin e vitit 2016, me rastin e ditëlindjes së Pejgamberit ﷺ, realizuam një intervistë me zotëri Ahmet Tashgetirenin. Menduam që botimi i kësaj interviste do të ishte i dobishëm pasi ajo u prit me interes edhe nga të tjerët. Bëmë disa shtesa duke përmirësuar tekstin, por pa e prishur stilin e intervistës. Këtë libërth po ua servirim lexuesve tanë me qëllim përfitimin dhe dobinë prej tij.

Allahu i Lartmadhëruar e bëftë këtë libërth shkak për shtimin e dashurisë ndaj Pejgamberit ﷺ. Allahu, me mirësinë dhe bujarinë e Tij, na dhashtë mundësinë e ndjekjes hap pas hapi të të Dërguarit të Allahut, me nënshtrim të plotë, siç ndjek hija trupin.

Amin…

Osman Nuri TOPBASH
Janar 2017
Yskydar



ÇFARË ËSHTË DITËLINDJA E PROFETIT?

Ahmet Tashgetiren: Zotëri çfarë është "ditëlindja e Profetit"? Kur dëgjojmë fjalën mevlud apo ditëlindje e Profetit, çfarë duhet të kuptojmë? Kam dëshirë që të arrijmë në një përkufizim të përgjithshëm të saj. Urdhëroni zotëri!


Osman Nuri Topbash: Le të fillojmë bashkëbisedimin duke falënderuar Allahun ﷻ. Sepse Zoti ynë na krijoi ne – Elhamdulilah!- si pjesë të umetit të Profetit ﷺ më të dashur të Tij, pa pasur ne ndonjë meritë. Ne, për të qenë umet i atij, mbretit të botërave, nuk kemi paguar asnjë çmim... Kjo është tërësisht mirësi e Tij.

Për mbarësinë e bisedës sonë, le t'i dërgojmë salavatet tona të përzemërta zotërisë sonë, të Dërguarit të Allahut ﷺ:

Salavat **Muhamed Mustafasë**, Zotërisë së dy botëve!..

Salavat për **Muhamed Mustafanë**, Pejgamberin e njerëzve dhe xhindëve.

Salavat **Muhamed Mustafasë**, Imamit të Mekës së shenjtë dhe Medinës së ndritshme.



اَللّٰهُمَّ صَلِّ عَلٰى مُحَمَّدٍ وَ عَلٰى اٰلِهٖ وَ صَحْبِهٖ وَ بَارِكْ وَ سَلِّمْ

Si fillim ua uroj të gjithë vëllezërve ditën në të cilën Krenaria e Gjithësisë e nderoi këtë botë me praninë e tij.

Lus Allahun Teala që kjo ditë e shenjtë të bëhet shkak për mëshirë, bereqet, mirësi për vendin tonë, popullin tonë dhe për të gjithë botën Islame!

Dita e Mevludit nënkupton ditën kur erdhi si mëshirë për botët i Dërguari i Allahut Teala.

Që ta perceptosh si duhet Mevludin, duhet para së gjithash të ndjesh kënaqësinë dhe prehjen e të qenit pjesë e umetit të Krenarisë së Gjithësisë.

Ai shënon kulminacionin profetik. Çdo profet është dërguar për një shoqëri të caktuar. Ndërsa Zotëria ynë, Resulullahu ﷺ, është "Rahmeten li'l-Alemin", pra i dërguar si mirësi për të gjithë universin deri në ditën e kiametit.

I Dërguari i Allahut është manifestimi i artit hyjnor në botën njerëzore. Është "**shembulli më i mire"** për të gjitha profesionet, karakteret dhe personalitetet.


Rruga që nuk shpie tek ai ﷺ, nuk arrin as në xhenet dhe as te bukuria e Allahut.

Ashtu siç freskuan sahabët besëlidhjen e tyre ndaj Profetit në Akabe apo Hudejbije, ashtu le ta freskojmë edhe ne besëlidhjen tonë me të në këtë ditë të begatë Mevludi.

Ahmet Tashgetiren: Zoti qoftë i kënaqur me ty Zotëri! Përcaktimi në muajin Prill i javës së Profetit apo festimi i ditëlindjes së Profetit Muhamed ﷺ në muajin Rebiulevvel, a përbën rrezikun e gjallërimit të raportit tonë me Profetin në vetëm një kohë, duke neglizhuar këtë raport në kohët e tjera? Ashtu siç janë përcaktuar festat e nënave dhe baballarëve, ashtu edhe me përcaktimin e festës së Profetit mund të lindë rreziku i mospërkujtimit të tij në ditët e tjera...

Osman Nuri Topbash: Zotëri, *"Njeriu është me atë që do!"* Dhe mbajtja gjallë e kësaj lidhjeje është domosdoshmëri e dashurisë. Ai që do, nuk e harron të dashurin e vet në asnjë kohë dhe në asnjë vend. Siç e dimë, edhe në muajin e Ramazanit përjetohet një gjendje emocionale e thellë. Ne agjërojmë duke u tërhequr edhe nga veprimet e lejuara. Përpiqemi ta zgjerojmë mëshirën, dhembshurinë, empatinë. Në fund vjen Bajrami si mirësi nga Allahu Teala.

Ashtu siç duhet që, virtytet që fitojmë gjatë muajit të Ramazanit, si mëshira, empatia, kujdesi në të ngrënët, vetëkontrolli, thellimi në adhurime, t'i shpërndajmë në të gjithë vitin, duke e shndërruar të gjithë jetën në një Ramazan të begatë dhe frymën e fundit në një Bajram; njëlloj duhet të ndodhë edhe me Mevludin. Ashtu siç përpiqemi ta përmendim, ta kuptojmë dhe ta thellojmë afërsinë me Resulullahun gjatë ceremonive të Mevludeve, ashtu



është domosdoshmëri që t'i përhapim këto përpjekje edhe në përditshmërinë tonë. Harresa e përfshirjes së Resulullahut në çdo plan të jetës dhe përkujtimi i tij vetëm në ditë të caktuara, tregon mungesë të theksuar sinqeriteti në dashurinë ndaj tij.

Thënë më hapur, nëse e përkujtojmë Profetin në xhami, në hutbe, në bashkëbisedime, në Umre, dhe e harrojmë në shtëpi, në vendin e punës, në shkollë, në treg, do të thotë që raporti jonë ka probleme.

Përkujtimi dhe përpjekja për ta kuptuar Profetin tonë në ceremonitë e festimeve të ditëlindjes së tij, janë mjete thellësisht të domosdoshme për të përmirësuar lidhjen tone me të. Por ruajtja e raportit tonë shpirtëror me Profetin ﷺ në çdo segment të jetës dhe përkujdesja ndaj ndjekjes së sunetit të tij, janë më të domosdoshme dhe të paevitueshme.

Allahu i Lartmadhëruar e cilëson Profetin ﷺ, si **"shembullin më të përsosur"**.

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِى رَسُولِ اللهِ اُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِمَنْ كَانَ يَرْجُوا اللهَ وَالْيَوْمَ الْاٰخِرَ وَذَكَرَ اللهَ كَثِيرًا

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."
(Ahzab, 21)

Atëherë, vendi i Resulullahut në jetën tonë nuk është një ditësh apo një stinësh, por duhet të mbushë çdo fazë të jetës sonë.

Ahmet Tashgetiren: Pra jo vetëm në ceremonitë e Mevludeve!


Osman Nuri Topbash: Mevludet duhet të na rifreskojnë dëshirën dhe të na shumëfishojnë emocionin.

Ahmet Tashgetiren: Detyra e këtyre ditëve është që të na ndezin zjarrin e dashurisë ndaj Profetit ﷺ, apo jo zotëri?

Osman Nuri Topbash: Po, dashuria ndaj Resulullahut ﷺ, dhe përhumbja jonë shpirtërore tek ai, duhet të përndizen. Pra, njeriu nuk e harron kurrë atë që do dhe e përmend në çdo rast. Çdokush e do dhe e përmend më shumë atë tek i cili sheh mirësi.

Çfarëdo që një qënie e përkohshmë të na japë, ajo lidhet me jetën tonë të kësaj bote. Allahu i Lartmadhëruar, duke na dhuruar Islamin përmes udhëzimit të Profetit Muhamed ﷺ, na ka falur lumturinë për jetën e kësaj bote të përkohshme dhe për Ahiretin. Pra i Derguari i Allahut, ﷺ, na ka servirur mirësi të cilat nuk mund të na i servirë asnjë i vdekshëm, prandaj secili prej nesh i detyrohet falënderime Profetit.

Ahmet Tashgetiren: Ajeti i fundit i sures Xhuma, i cili zbriti teksa Profeti ﷺ po mbante hutben, jepte lajmin e ardhjes së një karvani në Medinë, ku tekstualisht thuhet:



وَاِذَا رَاَوْا تِجَارَةً اَوْ لَهْوًا انْفَضُّوا اِلَيْهَا وَتَرَكُوكَ قَائِمًا
قُلْ مَا عِنْدَ اللهِ خَيْرٌ مِنَ اللَّهْوِ وَمِنَ التِّجَارَةِ
وَاللهُ خَيْرُ الرَّازِقِينَ

"Mirëpo, sa herë që ata shohin ndonjë tregti ose lojë, shkojnë tek ajo e të lënë ty në këmbë. Thuaj: 'Ajo që është tek Allahu, është më e mirë nga argëtimi e nga tregtia.' Allahu është Dhuruesi më bujar." (Xhuma, 11)

*Kalimi në ajet i shprehjes **"Të lënë ty në këmbë"**, na paralajmëron ne për marrëdhëniet e tilla.*

Osman Nuri Topbash: Me të vërtetë Zoti ﷻ na tërheq vëmendjen në lidhje me një temë të rëndësishme në këtë ajet. Në fakt kjo nuk vlen vetëm për personat që u larguan nga Profeti ﷺ në ditën kur u zbrit ajeti, por edhe ndaj çdokujt që largohet nga shërbimi. Thënë me fjalët e Kuranit, ndaj atyre që preferojnë "lojën dhe argëtimin". Allahu ﷻ u tërheq vëmendjen atyre që preferojnë tregtinë kundrejt ahiretit. Paralajmëron personat që zhyten në indiferencën e marrjes kënaqësi vetëm nga dynjaja. Në ditët tona, fatkeqësisht edhe në rrethin tonë, harrohen ndjeshmëritë e Profetit, e në mënyrë të veçantë gjatë tregëtisë harrohen parimet e Islamit. Allahu ﷻ vazhdimisht na tërheq vëmendjen që të mos neglizhohen këto parime.


Ahmet Tashgetiren: Paralajmërim edhe për mungesën e pranisë së Resulullahut në jetën tonë, apo jo zotëri? Një lidhje vetëm me ceremoninë e Mevludit. Ngopja vetëm me ceremoninë, pra qasja "u takuam me Profetin dhe u ngopëm me të". Mirëpo Resulullahu mungon në çdo sekond të jetës sonë.

Osman Nuri Topbash: Në çështjet materiale ekziston gjithmonë një pikë ngopjeje. Për shembull: ju merr uria shumë, hani disa pjata dhe ngopeni. Nëse ju sjellin më tepër ushqim se mund të hani, ju nuk e hani dot dhe e lini aty. Të gjitha kënaqësitë e dynjasë janë të tilla.

Rumiu shprehet:

"Nëse i vëzhgon mirë ata që zhyten në punët e dynjasë, që punojnë dhe përpiqen pakufi, do të kuptosh që përpjekjet e tyre me insistim janë si shtresat e qepës që mbajnë erë të keqe. Të gjitha këto përpjekje dhe punë janë njëra më bosh se tjetra. Ndërsa punët në rrugën e Hakut, janë njëra më plot se tjetra, pra njëra më me thelb dhe më e bukur se tjetra."

Pra Mevlana, përpjekjet dhe kënaqësitë tokësore i krahason me kënaqësitë që merren nga hudrat dhe qepët. Ata ju hapin oreksin, por pastaj bëhen shqetësuese edhe për ju, edhe për personat që keni përreth. Ndërsa përpjekja shpirtërore nuk është e tillë. Sa më shumë t'i afroheni Allahut, aq më shumë



ju shtohet oreksi për të ecur në rrugën e Tij. Njeriu nuk ngopet kurrë shpirtërisht.

Kur shohim pejgamberët, vërejmë të njejtën pamje. Madje edhe kur ata ishin në sprovat më të forta... Për shembull Ibrahimi عليه السلام u sprovua me jetën, pasurinë dhe fëmijën e tij, kaloi vështirësi të jashtëzakonshme, u bë mik i Allahut ﷻ, e megjithatë gjatë kënaqësisë së afrimit me Allahun Teala shprehej:

وَلَا تُخْزِنِى يَوْمَ يُبْعَثُونَ

"...dhe mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit." (Shuara, 87)

O Zot, çfarë niveli i lartë shpirtëror!..


E njëjta gjë mund të thuhet edhe për lidhjen me Resulullahun, ﷺ, me të vërtetë është një kënaqësi me të cilën njeriu s'ka të ngopur. Pra, kjo lidhje nuk mund t'i përkasë një kohe apo një momenti specifik. Të lutem më lejo të jap një shembull zotëri Ahmet.

Ahmet Tashgetiren: Ju lutem vazhdoni, është kënaqësi për mua.

Osman Nuri Topbash: Nëse një miliarder duke ecur në rrugë humbet një sasi të vogël parashë, a mërzitet për këtë? Jo, sepse sasia e humbur në raport me pasurinë e madhe që ai ka, është e papërfillshme.

Pasuria jonë më e madhe është Profeti ﷺ.

Vuajtjet dhe sprovat e kohëve tona në raport me mirësinë dhe kënaqësinë e të qënit umet i Resulullahut ﷺ, duhet të jenë po ashtu të papërfillshme. Duhet të jemi të vetëdijshëm që jetojmë në botën e sprovës. Duhet t'ia kujtojmë vetes vazhdimisht vuajtjet që ka kaluar Resulullahu dhe sahabët e tij. Kjo mënyrë të menduari do të na sigurojë një jetë më të qetë e më të lumtur.



TË RIFRESKOJMË BESËLIDHJEN ME TË DËRGUARIN E ALLAHUT

Ahmet Tashgetitren: Zotëri, më sipër përmendët besëlidhjen me Resulullahun, ﷺ. Theksuat faktin që lidhjen me Resulullahun duhet ta kemi të vazhdueshme dhe të gjallë gjatë gjithë jetës. A mund të na flisni pak për këtë besëlidhje i nderuar? A mund të na e hapni pak brendësinë e kësaj teme?

Osman Nuri Topbash: Allahu i Lartmadhëruar, për dyzet vjet me radhë, e edukoi Resulullahun ﷺ me moralin më të bukur. Asnjë njeri i shoqërisë së asaj kohe nuk foli asnjë fjalë të keqe në lidhje me të ndonjëherë. Kur ai mbërriti në të dyzetat, i erdhi shpallja. Kështu filloi të ndërtohej një sistem i tërë akaidi (doktrinë besimi) mbi moralin e bukur.

اِقْرَاْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِى خَلَقَّ

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)." (Alak, 1)

Urdhërin "lexo" duhet ta kuptojmë si udhër që i është dhënë zemrës për të lexuar.

Në periudhën e Mekës, pra për 13 vite, sahabët e nderuar u vunë në provë edhe për akaidin por


edhe për forcën e imanit në zemrat e tyre. Përjetuan të gjitha llojet e fatkeqësive dhe padrejtësive. Por ata treguan një besnikëri të plotë ndaj Resulullahut, ﷺ, siç tregon hija bindje ndaj trupit. Ja pra, besëlidhja është pikërisht kjo besnikëri. Allahu i Lartmadhëruar në suren Teube, ajeti 111, ka thënë:

اِنَّ اللّٰهَ اشْتَرٰى مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اَنْفُسَهُمْ وَاَمْوَالَهُمْ
بِاَنَّ لَهُمُ الْجَنَّةَ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللّٰهِ فَيَقْتُلُونَ وَيُقْتَلُونَ
وَعْدًا عَلَيْهِ حَقًّا فِي التَّوْرٰيةِ وَالْاِنْجِيلِ وَالْقُرْاٰنِ
وَمَنْ اَوْفٰى بِعَهْدِهِ مِنَ اللّٰهِ فَاسْتَبْشِرُوا بِبَيْعِكُمُ الَّذِى
بَايَعْتُمْ بِهِ وَذٰلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) **premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore.”** (Teube, 111)

Kjo do të thotë qe besëlidhja është një sakrificë. Allahu i Latmadhëruar në ajetin e mësipërm na informon për shpërblimin e sakrificës.

Ne jemi informuar nga historia islame për besëlidhjet e Akabesë dhe besëlidhjen e Hudejbijes.



Por hera herës sahabët shkonin personalisht te Resulullahu dhe freskonin besëlidhjen me të. I thonin shpesh "Të qofshin falë jeta, pasuria dhe çdo gjë e imja, o Resulullah! Urdhëro çfarë të kesh dëshirë!" Kështu, sahabët nuk u mjaftuan vetëm me besëlidhjet e Akabesë e të Hudejbijes, por e mbajtën gjallë besëlidhjen vazhdimisht, në shpirtin e në zemrën e tyre. Atë e perceptuan si amanetin më të rëndësishëm të jetës...

Kjo është besëlidhja e domosdoshme që duhet të bëjmë edhe ne. Jetojmë 14 shekuj pas të Dërguarit të Allahut, ﷺ. Në këtë shekull të 21-të që po jetojmë e ku po mbretëron dhuna, pyetjet që duhet t'i shtrojmë vetes janë:

- Si mund t'u ngjamë sahabëve të nderuar? Si mund të ecim hap pas hapi në gjurmët e Resulullahut, siç ecën sahabët?

- Si mund të jetojmë duke qenë në përpikëri me besëlidhjen ndaj Resulullahut, siç ishin sahabët e nderuar?

Unë besëlidhjen e kuptoj si besnikëri. Pra të ndjekësh atë çfarë dëshiron Resulullahu, ﷺ, deri në detajin e shkronjës.

Kur Hint binti Amr, Sumejra Hatun e plot sahabe të tjera, kur morën lajmin e rënies dëshmorë të bashkëshortëve, baballarëve, e fëmijëve, më parë kërkuan: "Ju fillimisht na informoni në lidhje me Resulullahun!" Dashuria për Resulullahun, ﷺ, i kishte eklipsuar dashuritë e tjera.

Ebu Bekrin ﷺ e rrahën fort kur ai doli në Qabe për të ftuar njerëzit në fenë Islame. Atij nuk i mbeti forcë as të ecte në këmbët e veta. E sollën në shtëpi duke e mbajtur për krahësh. Nëna u merakos shumë për të birin e dashur të saj. Ndërsa shqetësimi i Ebu Bekrit ﷺ ishte vetëm për gjendjen e Resulullahut, ﷺ. Ai e pyeti nënën e tij të dashur:


"Nënë ti fillimisht më trego në çfarë gjendje është Resulullahu?"

Kjo ndjesi e Ebu Bekrit ﷺ e çuditi shumë nënën e tij... Ja pra kulminacioni i besëlidhjes me Resulullahun, ﷺ.

Allahu i Lartmadhëruar na e sqaron shkoqur besëlidhjen me Resulullahun, ﷺ. Në një ajet kuranor Ai ﷻ shprehet:

اِنَّ الَّذِينَ يُبَايِعُونَكَ اِنَّمَا يُبَايِعُونَ اللّٰهَ يَدُ اللّٰهِ فَوْقَ اَيْدِيهِمْ فَمَنْ نَكَثَ فَاِنَّمَا يَنْكُثُ عَلٰى نَفْسِهٖ وَمَنْ اَوْفٰى بِمَا عَاهَدَ عَلَيْهُ اللّٰهَ فَسَيُؤْتِيهِ اَجْرًا عَظِيمًا

"Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre! Ai që e prish betimin, e prish në dëm të vetes, por, nëse e mban besën ndaj Allahut, Ai do t'i japë atij shpërblim të madh." (Feth, 10)



Ahmet Tashgetiren: Kjo besëlidhje nënkupton kapjen për dore me Resulullahun, ﷺ, apo jo zotëri?

Osman Nuri Topbash: Kapja për dore me Resulullahun, në një aspekt tjetër, kupton shtimin e dashurisë për të. Dashuria forcon komunikimin shpirtëror me Resulullahun, ﷺ.

Ahmet Tashgetiren: Pra ajo nga dora na shpie për në zemër?

Osman Nuri Topbash: Ajo e skalit dashurinë në zemër.

Ahmet Tashgetiren: Pra edhe ne në kohët tona duhet të dimë të edukohemi me ngrohtësinë e kapjes për dore me Resulullahun, ﷺ, duke u ndjerë të kapur edhe nga dora e tij e ëmbël?

Osman Nuri Topbash: Në fakt kjo është rabëtaja (lidhja e brendshme shpirtërore). Kultivimi dhe mbajtja në gjendje të freskët e dashurisë.

Ahmet Tashgetiren: Të qënit i lidhur me Resulullahun, ﷺ.

Osman Nuri Topbash: Të mos e shkëpusësh lidhjen shpirtërore me Resulullahun, ﷺ, në një asnjë fragment të jetës... si në kohë bollëku ashtu edhe në kohë skamjeje. Versionin më kulminant të dashurisë e shohim mes Resulullahut ﷺ, dhe Ebu Bekrit رضي الله عنه.

Një ditë Omeri رضي الله عنه ia shprehu dashurinë Resulullahut duke i thënë:

"O i Dërguari i Allahut nuk kam gjë më të dashur se ty në këtë jetë, veç vetes time."

I Dërguari i Allahut, ﷺ, u shpreh:

"-Jo, unë duhet të jem edhe më i dashur se vetja jote!"

Menjëherë Omeri, رضي الله عنه, tha:

"-Atëherë unë (që nga ky çast) të dua më shumë se veten time, o Resulullah!"

Pas kësaj Resulullahu, ﷺ, u shpreh:

"-Tani po (që jemi në rregull)." (Buhari, Ejman, 3)

Në një hadith tjetër Resulullahu, ﷺ, ka thënë:

"Nuk keni besuar plotësisht nëse nuk më doni mua më shumë se nënën, babain, fëmijët tuaj e më shumë se të gjithë njerëzit e tjerë." (Buhari, Iman, 8.)

Në një ajet kuranor, Allahu i Lartmëdhuaruar ka thënë:

اَلنَّبِیُّ اَوْلٰی بِالْمُؤْمِنِیْنَ مِنْ اَنْفُسِهِمْ

"I Dërguari i Allahut është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri tjetrin..." (Ahzab, 6)

Mbajtja e Resulullahut, ﷺ, më lart se gjithë të tjerët, dhe të dashurit atë me një dashuri të pashembullt, janë tregues të plotësimit e përsosjes së imanit.

Kur Resulullahu, ﷺ, i pyeste sahabët për ndonjë gjë, si për shembull:

"Kush do t'ia dërgojë Heraklitit këtë letër?"

I madh e i vogël çohej në këmbë e thoshte:

"-O i Dërguari i Allahut ma beso mua këtë nder e lavdi!"

Secili e dinte që letrën do ta lexonte në mesin e xhelatëve të cilët me një shenjë të mbretit ishin gati t'ia fluturonin kokën. Ata as që e mendonin këtë, e kështu nuk tregonin asnjë hezitim apo ngurrim përballë kërkesës së Resulullahut, ﷺ. Kështu sahabët rifreskonin besëlidhjen me Resulullahun, ﷺ, teksa përballeshin me situata të ndryshme.

KUSHTI I VETËM I AFRIMIT ME RESULULLAHUN ËSHTË TAKVAJA

Ahmet Tashgetiren: Në Epokën e Lumturisë kemi të bëjmë me edukim në klimën e dashurisë. Po ne si mund ta shtojmë dashurinë për Resulullahun, ﷺ? Sahabët si mund të na shërbejnë ne si model në këtë përpjekje?

Osman Nuri Topbash: Një dervish i drejton një pyetje një njeriu të urtë:


"A është më i madh Xhunejdi Bagdadi apo Bajezid Bistami?"

Ai njeri i madh i dha këtë përgjigje:

"Për të caktuar madhësinë e virtytit të këtyre dy evlijave, duhet të jesh evlija më i madh se ata të dy..."

Përcaktimi plotësisht i evlijave të Allahut, nuk është asnjëherë i mundur nga shqisat tona. Kur kapaciteti i perceptimit njerëzor nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar vlerat e evlijave të Allahut, mendoni sa pak është në gjendje të përcaktojë vlerat e më të Dashurit të Allahut Teala.

Prandaj me shqisat tona të mangëta ne nuk mund të përcaktojmë vlerën reale të Profetit ﷺ.



Ai është një mirësi e pafundme, dhuratë e madhe hyjnore, mëshirë për të gjitha botët...

Kam dëshirë të jap edhe një shembull tjetër. Resulullahu, ﷺ, e donte shumë Muadh ibn Xhebelin. Ai transmeton:

"I Dërguari i Allahut, ﷺ, më nderoi duke më përcjellë jashtë Medinës kur më emëroi vali në Jemen. Unë isha i hipur mbi kafshë e ai po ecte në këmbë. Pasi më dha disa këshilla, ai më tha:

«- O Muadh! Ndoshta pas këtij viti nuk do më shohësh më. Mundet që do më vizitosh varrin këtu në mesxhidin tim!»

Pasi dëgjova këto fjalë, fillova të qaja nga trishtimi i ndarjes me Profetin, ﷺ. Resulullahu, ﷺ, ktheu fytyrën nga Medina dhe u shpreh:

«- Mos qaj o Muadh! Ata që janë afër meje nga njerëzit, janë të devotshmit që i frikësohen Allahut!»"

Kjo shprehje është shumë domethënëse për ne. Krenaria e njerëzimit ka thënë:

"Me të vertetë miqtë e mi janë ata që i frikësohen Allahut." (Ebu Davud, Fiten/4242.)

Duhet ditur se secili e njeh Profetin ﷺ nisur nga grada e tij e devocionit dhe dashurisë. Ebu Bekri رضي الله عنه e pa Resulullahun, ﷺ, u mahnit pas tij dhe përmallohej për të edhe duke qenë përkrah tij...

Xhabir ibn Semure رضي الله عنه na tregon:

"E pashë Profetin në një natë me hënë, kishte veshur një rrobë të kuqe. Kalova shikimin disa herë sa nga Profeti, ﷺ, e sa nga hëna. Ai m'u duk shumë më i bukur se Hëna." (Tirmidhi, Edep, 47/2811; Darimi, Mukaddime, 10/58.)


Nëna jonë, Aishja ﵂ e ka përshkruar fytyrën e ndritur të Resulullahut kështu:

وَلَوْ سَمِعَ أَهْلُ مِصْرَ أَوْصَافَ حَدِّهِ
لَمَا بَذَلُوا فِى سَوْمِ يُوسُفَ مِنْ نَقْدٍ
لَوَائِمُ زُلَيْحَا لَوْ رَأَيْنَ جَبِينَهُ
لَآثَرْنَ بِالْقَطْعِ الْقُلُوبَ عَلَى الْأَيْدِ

"Sikur të kishin dëgjuar për bukurinë e fytyrës së Resulullahut, ﷺ, banorët e Misirit, nuk do të harxhonin asnjë kurush në pazar për të blerë Jusufin ﵇. Gratë që folën keq për Zulejhanë, sikur ta shihnin nurin e ballit të Resulullahut, në vend të duarve do të prisnin zemrat e tyre."

Si rezultat i takvasë dhe dashurisë, Allahu i Lartmadhëruar mundëson manifestimin e të vërtetave të Resulullahut në zemrat tona. Intensiteti i marrëdhënies sonë me Resulullahun, ﷺ, dhe përafrimi jonë me të, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me takvanë, pra devocionin.

Atëherë në mendje na vjen pyetja: Si mund ta fitojmë takvanë (devocionin)?



Zotërimi i takvasë apo devocionit realizohet nëpërmjet shembjes së dëshirave të nefsit dhe zhvillimit të prirjeve shpirtërore, mundësohet duke e kthyer ne vetëdije të zemrës faktin që jemi vazhdimisht nën vëzhgimin hyjnor.

وَهُوَ مَعَكُمْ اَيْنَ مَا كُنْتُمْ

"... Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni..." (Hadid, 4)

وَنَحْنُ اَقْرَبُ اِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ

"Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet." (Kaf, 16) Duke u vetëdijësuar për ajetin në fjalë dhe duke jetuar çdo sekond të jetës brenda këtij perceptimi, arrihet takvaja. Kur realizohet kjo, atëherë zemra fiton nivelin:

اَلَا بِذِكْرِ اللهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ

"Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!" (Ra'ad, 28) Zemra mbushet me Allahun ﷻ. Kur themi mbushet, kemi parasysh angazhimin e saj me Zotin. Kështu robi, duke u angazhuar vazhdimisht me Hakun, nuk e nxjerr nga vëmendja asnjëherë Atë, në qendrën e mendimit të Tij është vazhdimisht Zoti.

Mund ta vijojmë temën tonë duke shtruar pyetjen: Kë do më shumë Zoti, cilin shembull na sugjeron Ai?

Zoti ynë na sugjeron të marrim shembull Pej-

gamberin, ﷺ, kështu ne nuk kemi asnjë mundësi tjetër zgjedhjeje përveç se ndjekjen e gjurmës së tij. Duke menduar në këtë formë, ne duhet ta shtojmë dashurinë ndaj Resulullahut, ﷺ.

Ahmet Tashgetiren: Çfarëdo rruge që të ndiqet duhet të na shpjerë te Resulullahu. Allahu i Lartmadhëruar na orienton pikërisht drejt kësaj pike.

Osman Nuri Topbash: Sigurisht… Rruga për t'u takuar me Zotin, kalon nga takimi me mbretin e zemrave, Zotërinë tonë, Resulullahun, ﷺ. Ndërsa rruga e takimit me Resulullahun, ﷺ, kalon nga dashuria. Treguesi i takimit me Të, është pikërisht dashuria.

Ndërsa treguesi i takimit me Resulullahun cili është? Është edukimi i sjelljes dhe veprës simbas sheriatit. Pajisja me moralin e tij, mbrujtja me edukatën e tij, pra të qënit në përpjekje të vazhdueshme për t'iu afruar gjendjeve të tij dhe për të peshuar veprën simbas sunetit të tij. Kjo është e vetmja rrugë që duhet të ndjekim.

Ahmet Tashgetiren: Të armatosemi me moralin e Resulullahut, ﷺ.

Osman Nuri Topbash: Sahabët kishin një dashuri jashtëzakonisht të madhe për Profetin ﷺ. Për shembull Abdullah ibn Omeri رضي الله عنه, pasi ndërroi jetë Resulullahu, ﷺ, kalonte në rrugët ku kishte kaluar Profeti duke e menduar atë. Ulej rrëzë pemë-

ve ku ishte ulur Profeti të pushonte, e që të mos thaheshin këto pemë, kudo ku ato ndodheshin, në mal apo në fushë, ai i ujiste.

Gjithashtu sahabët nuk kalonin ku shihnin në tokë pështymë, por e mbulonin siç e kishte mbuluar Resulullahut, ﷺ. Ata ishin të shkrirë tërësisht me gjendjet e Resulullahut ﷺ. Të gjitha këto janë pjesë e edukimit që vijnë nga dashuria për Profetin ﷺ.



MENDJA IU BËFTË KURBAN RESULULLAHUT

Ahmet Tashgetiren: Zotëri, njeriu i kohëve tona pandeh se vë mendjen e logjikën në punë. Kur Resulullahu u kthye prej atje pati një arsye. Po ti çfarë arsyeje ke? Resulullahu pati një arsye pse u ul nën pemë për të pushuar, kurse ti nuk ke arsye ta bësh një gjë të tillë. Sikur të përpiqeshim t'i kuptonim këta që kanë një qasje të tillë?

Osman Nuri Topbash: Vëllai im Ahmet, kjo qasje quhet racionalizëm dhe buron nga mungesa e dashurisë. Nëse shtohet dashuria, kapërcehen lehtësisht këto mendime. Kur nëna e përcjell djalin e dashur të saj për në ushtri apo për ndonjë udhëtim dhe e merr malli për të, e kujton edhe kur sheh një ushqim që e preferon i biri. Nuk ka ndonjë logjikë në atë çfarë nëna mendon. Por dashuria e kapërcen logjikën e mendimin. Për këtë Rumiu ka thënë:

"Mendja, edhe pse në çështjet e kësaj bote na siguron sukses, nuk mundet që e vetme të na shpjerë në marifetullahun, njohjen e Allahut dhe të sekreteve të Tij. Në udhëtimin e shenjtë qiellor duhet domosdo një mjet. Dhe ai mjet është shpirti, dashuria, përhumbja e soditja. Mendja iu bëftë kurban Resulullahut, ﷺ."

Ahmet Tashgetiren: Shumë, ama shumë e bukur.

Osman Nuri Topbash: Për secilin prej nesh mendja ka rëndësinë e saj, por deri në masën e duhur. Mendja ka vlerën e saj edhe brenda shpalljes. Por edhe aty deri në njëfarë mase. Mirëpo pjesa më e madhe e filozofëve, prej se adhurojnë mendjen, privohen edhe nga shpallja, por edhe nga dashuria. Racionalistët pasi vdesin, shuhen e harrohen. Nuk kanë kapacitetin e mjaftueshëm t'u japin jetë kohëve që u përkasin të ardhmes. Kurse mesazhet dhe mirësia e dashurisë së njerëzve të shpirtit, si Rumiu, e ruajnë freskinë edhe në shekujt e mëvonshëm. Ibn Arabiu, vazhdon të ekzistojë, miqtë e tjerë të Hakut janë të gjallë.

Sigurisht edhe dashuria ka nevojë të purifikohet. Por mendja është si thikë me dy presa, ajo mund të bëjë edhe mirë edhe keq. Nëse kalon në një proces purifikimi e pastrimi, ajo natyrshëm zë vendin e duhur që i takon.




PURIFIKIMI I DASHURISË

Ahmet Tashgetiren: Si mund të purifikohet dashuria zotëri?

Osman Nuri Topbash: Përgjigjen e pyetjes tënde do ta filloja me shembullin e Junus Emresë. Para se shehu Taptuk Emre ta pranonte atë në dergjahin e tij, e la për një kohë në pragun e portës, aty ku shkelin me këmbë të gjithë. Junus Emre, ankthet e para metafizike i kaloi në pragun e derës, mësimin e parë të luftës me egon e mori në atë prag. Më vonë iu dha leja të hyjë në dergjah. Nga kjo kuptojmë se në shkallën e parë duhet të luftohet egoja deri në shkatërrimin e saj.

Mendjemadhësia është një tipar i përbuzshëm. Allahu nuk e toleron mendjemadhësinë. Të thuash për një gjë, që me bujari të është dhuruar nga Allahu i Lartmadhëruar, "kjo është vetëm e imja", është një veprim shumë egoist, indiferent, madje injorant.

Racionalistët janë prekur nga sëmundja e mungesës së dashurisë. Nëse nuk shihni me dashuri e gjallëri emocionale, atëherë do t'ju bëhet koka lëmsh. Pastaj do t'ju prishet nijeti. Prishja e nijetit e shpie njeriun drejt veprave të këqija. Ju e keni vënë re që në Turqi është zhvilluar një ekol që mbivlerëson



Kuranin. Ata dalin shpesh e deklarojnë që duhet ta kuptojmë Kuranin nga këndvështrimi i "myslimanit të kuranit".

A nuk i shohin ata në Kuranin Famëlartë ajetet që lidhen me të Dërguarin e Tij:

لَكَ رُمْعَلَ / **"Betohem për jetën tënde** (o Muhamed)**..."** (Hixhr, 72)

Në suren Asr në ajetin e parë وَالْعَصْرِ Allahu i Lartmadhëruar betohet në epokën e Resulullahut, ﷺ.

Në ajetet e para të sures Beled Allahu ﷻ betohet për zonën ku jeton i Dashuri i Tij:

لَآ اُقْسِمُ بِهٰذَا الْبَلَدِ ﴿١﴾ وَاَنْتَ حِلٌّ بِهٰذَا الْبَلَدِ ﴿٢﴾

"Betohem për këtë vend, në të cilin ti je i lirë (o Muhamed)**..."** (Beled, 1-2)

Në suren Jasin bëhet betimi për profecinë e tij:

يٰسٓ ﴿١﴾ وَالْقُرْاٰنِ الْحَكِيمِۙ ﴿٢﴾

اِنَّكَ لَمِنَ الْمُرْسَلِينَۙ ﴿٣﴾ عَلٰى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٤﴾

"Jâ Sîn. Për Kuranin plot urtësi! Në të vërtetë, ti (Muhamed) **je një nga të dërguarit, në rrugë të drejtë..."** (Ja Sin, 1-4)

Allahu i Lartmadhëruar e ka marr Vetë përsipër ruajtjen e shpalljes që na ka dërguar nëpërmjet të Derguarit të Tij.

Në lidhje me këtë të fundit në Kuranin Famëlartë ka thënë:

اِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَاِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ

"Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë." (Hixhr, 9)

Në një ajet tjetër thuhet:

اِنَّ اللهَ وَمَلٰئِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ
يَآ اَيُّهَا الَّذِينَ اٰمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me 'selam'!" (Ahzab, 56)

Zoti ynë dëshiron nga ne një dorëzim të plotë tek i Dërguari i Tij.

Nëse gjatë namazit i japim dikujt selam, namazi prishet. Ndërsa gjatë etehijjatus është obligim t'i dërgojmë salavatet e selamet tona Resulullahut ﷺ. Aq shumë e do Allahu i Lartmadhëruar të Dërguarin sa na obligon ne në çdo namaz t'i dërgojmë selamet tona.

Allahu i Lartmadhëruar edhe familjen e Resulullahut e ka lartësuar mbi të tjerët. I ka pastruar duke larguar prej tyre çdo papastërti dhe na ka obliguar që krahas Resulullahut t'u dërgojmë edhe atyre salavatet tona.

Në ajetin 23 të sures Shura, Allahu i Lartma-

dhëruar na urdhëron t'i duam të afërmit e Resulullahut, ﷺ:

ذٰلِكَ الَّذِى يُبَشِّرُ اللّٰهُ عِبَادَهُ الَّذِينَ اٰمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ
قُلْ لَا اَسْئَلُكُمْ عَلَيْهِ اَجْرًا اِلَّا الْمَوَدَّةَ فِى الْقُرْبٰى وَمَنْ
يَقْتَرِفْ حَسَنَةً نَزِدْ لَهُ فِيهَا حُسْنًا اِنَّ اللّٰهَ غَفُورٌ شَكُورٌ

"Kështu i gëzon Allahu robërit e Vet, që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira. Thuaju: 'Për këtë nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi tjetër prej jush, përveç respektit (për mua) **për hir të farefisnisë** (që kemi)**.' Atij që bën vepër të mirë, Ne do t'ia shtojmë shpërblimin. Allahu, me të vërtetë, është Falës dhe Mirënjohës."** (Shura, 23)

Në suren Zuhruf, ajeti 44, Allahu ﷻ e ka nderuar popullin dhe fisin e tij.

Vajzën e tij, Fatimen ﵂ e ka bërë zonjën e xhenetit, por edhe zonjën e të gjitha grave të kësaj bote.

Bashkëshortën e tij të parë, Hatixhen ﵂, e ka përgëzuar me një qoshk të mrekullueshëm xheneti.

Nipat e dashur të tij, Hasanin dhe Hysejnin ﵄, i ka nderuar me gradën e zotërinjve të xhenetit; axhën e tij, Hamzanë, e ka përgëzuar me gradën e zotërisë së të gjithë shehidëve, sahabët e Profetit i ka nderuar me gradën e takvasë dhe i ka zgjedhur në mesin e të gjithë njerëzve duke u dhënë titullin sahab.

Shekullin kur Resulullahu, ﷺ, ka jetuar, e ka bërë kohën më të mirë në të gjithë historinë e njerëzimit, prandaj ajo quhet "Epoka e Lumturisë".

Kiblën e tij e bëri në drejtimin e të parit tempull të ndërtuar për njerëzimin.

Ashtu siç e shenjtëroi vendlindjen e tij, e shenjtëroi edhe Medinën e tij.

Mimberin e tij e lartoi mbi Havzin e xhenetit.

Distancën ndërmjet mimberit dhe shtëpisë së tij e bëri një kopsht xheneti.

Malin e Uhudit e bëri një mal të xhenetit.

Umetin e tij e bëri umet të qendrës dhe më të mirin, dëshmitar të umeteve të tjerë.

Shejtanin e tij e bëri t'i përkulej me bindje atij.

Ibn Abbasi رضي الله عنه ka thënë:

"Allahu nuk ka krijuar një njeri tjetër më me vlerë se Resulullahun, ﷺ. Unë nuk kam dëgjuar të jetë betuar Allahu ﷻ për jetën e dikujt tjetër përveç jetës së Resulullahut, ﷺ. (Ebû Nuajm, Delâilu'n-nubuvve, fq. 63, nr. 21; Kâdî Ijâz, Shifâ, I, 105.)

Në ajetin 107 të sures Enbija thuhet:

وَمَآ اَرْسَلْنَاكَ اِلَّا رَحْمَةً لِلْعَالَمِينَ

"Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed)**, veçse si mëshirë për botët."** (Enbija, 107)

Nëse Allahu i Lartmadhëruar me bujarinë e Tij e ka nderuar me çfarë thamë më sipër Resulullahun, ﷺ, do të thotë se Ai e do shume atë. Prandaj ne duhet të vrapojmë në njohjen e kësaj mirësie të madhe hyjnore, në nderimin e tij, në kuptimin e tij, në perceptimin e tij, në lartësimin dhe dashurinë e tij. Madje ky është obligim për këdo që dëshiron të përjetojë lumturinë e përjetësisë.



PËRJETIMI I LUMTURISË SË PËRJETËSISË ËSHTË I MUNDUR VETËM ME RESULULLAHUN

Gjatë një ekspedite ushtarake, Halid ibn Velidi, ﷺ, bujti pranë një fisi mysliman. Kryetari i fisit e pyeti atë:

"Mund të na bëni një shpjegim të plotë të të Dërguarit të Allahut?"

Halid ibn Velidi, ﷺ, iu përgjigj:

"Nuk e gëzoj kapacitetin e plotë për të shpjeguar bukuritë e zotërisë sonë, të Dërguarit të Allahut. Do të ishte krejt e pamundur të bëhej, nëse do të më kërkohej shpjegimi i tij me detaje."

Kryetari i fisit i tha:

"Atëherë na e shpjego atë me aq sa di. Na e përshkruaj atë në mënyrë të shkoqur."

Atëherë Halid ibn Velidi, ﷺ, u shpreh:

"اَلرَّسُولُ عَلٰى قَدْرِ الْمُرْسِلِ :

"**VLERA E TË DËRGUARIT LIDHET ME VLERËN E DËRGUESIT**!.."

Atë e ka dërguar Allahu i Lartmadhëruar, tani merreni vetë me mend vlerën dhe madhështinë e tij.

Resulullahu, ﷺ, në lidhje me domosdoshmërinë e bindjes ndaj tij, është shprehur:

"Çdo besimtar i umetit tim do të hyjë në xhenet. Përveç atyre që shmangen e refuzojnë."

Sahabët të çuditur pyetën:

"-E kush nuk ka dëshirë të hyjë në xhenet, o i Dërguari Allahut?"

I Dërguari i Allahut u shpreh:

"-Ai që më bindet mua do të hyjë në xhenet. Ai që më kundërshton e rebelohet ndaj meje do të thotë se nuk ka dëshirë të hyjë në xhenet."
(Buhârî, Itisam, 2.)

Resulullahu, ﷺ, është një mrekulli hyjnore sa i përket të qënit të tij "shembulli më i përsosur" për çdo shoqëri e për çdo shtresë të saj, për çdo kohë e vend. Nuk duhet nxjerrë nga mendja kurrë që Resulullahu, ﷺ, është një njeri, por jo si të gjithë njerëzit e tjerë. Siç shprehet edhe një poet i famshëm:

مُحَمَّدٌ بَشَرٌ لاَ كَالْبَشَرِ

بَلْ هُوَ كَالْيَاقُوتِ بَيْنَ الْحَجَرِ

"Resulullahu është një njeri, por jo si të tjerët. Siç është rubini në mesin e gurëve, është edhe Resulullahu në mesin e njerëzve."

Meqë natyrshëm tema na solli këtu, shfrytëzoj rastin të them:


Resulullahu, ﷺ, nga njëra anë është mbi kapacitetin tonë të perceptimit e nga ana tjetër është brenda fushës sonë të perceptimit. Pra ai është jashtë, por edhe brenda perceptimit njerëzor.

Ai është brenda fushës sonë të perceptimit prej-se Allahu i Lartmadhëruar e ka dërguar si shembullin më të përsosur për të gjithë njerëzimin. Nga aspekti i tipareve të tij të cilat duhen marrë shembull, çdo besimtar e njeh atë sipas kapacitetit të dashurisë që ka për të. Historia e vërtetë e Resulullahut është përpjekja e njohjes së tij në zemër. Kulminacionin e kësaj njohjeje e hasim tek Ebu Bekri رضي الله عنه.

Ndërsa kur themi që një anë e Resulullahut është jashtë kapacitetit njerëzor të perceptimit, kemi parasysh pamundësinë njerëzore për ta perceptuar në mënyrë tërësore të Dërguarin e Allahut, ﷺ. Fjalët e njerëzimit janë shumë të cekta për ta rrokur dhe shpjeguar tërësisht qënien madhështore të tij. Ai është i Dashuri i Allahut të Lartmadhëruar ndaj të cilit dërgojnë selam Ai së bashku me melekët e Tij dhe në jetën e të cilit Ai betohet në Kuranin Famëlartë.

Sa kuptimplotë është shembulli që Rumiu shpreh në vargjet e tij:

"Afrimet me Allahun e Lartmadhëruar janë të shumëllojshme. Dielli hedh dritën e tij mbi mal, gurë e mbi ar. Mirëpo dielli ka kaq afërsi me arin sa këtë nuk e kupton pema e shelgut.



Dielli është afër edhe degës së tharë, por edhe degës së njomë.

Koha kalon e nga afërsia e diellit me degën e njomë dhe të freskët dalin fruta të dashura, të shijshme, të pjekura e të bukura.

Kurse nga dega e tharë, edhe pse e prekur nga dielli njëlloj, a buron diçka tjetër veç thellimit të tharjes?"

Si përfundim, mund të themi që nuk kemi kapacitetin e mjaftueshëm për ta njohur tërësisht Resulullahun, ﷺ. Nuk e zë dot gota ujin e brokës, do të derdhet. Jo më kot Resulullahu, ﷺ, ka thënë: *"Sikur të dinit çfarë di unë, do të qanit shumë e do të qeshnit pak; (nuk do të hanit e pinit më) e do të përpëliteshit shkretëtirave..."* (Ibn Mâxhe, Zuhd, 19.)

Ahmet Tashgetiren: Pra duhet medoemos ta njohim atë.

Osman Nuri Topbash: Sigurisht duhet ta njohim atë, edhe pse kapacatiteti ynë për këtë është i pamjaftueshëm. Duhet të përpiqemi ta kuptojmë mirë atë pjesë të tij që është e perceptueshme për të gjithë ne. Pasi Kurani Famëlartë e përkufizon Resulullahun si "Usve-i Hasene". Shembulli, karakteri më i përsosur...



RRUGA PËR TEK DASHURIA E ALLAHUT TEALA, KALON NGA DASHURIA PËR PROFETIN ﷺ

Ahmet Tashgetiren: Atë duhet ta marrim shembull.

Osman Nuri Topbash: Po, rruga e dashurisë hyjnore kalon nga dashuria për Profetin ﷺ.

Pejgamberi ﷺ e kërkonte Dashurinë Hyjnore duke bërë duanë e Dautit عليه السلام:


"Zoti im, kërkoj prej teje dashurinë Tënde, dashurinë e atyre që të duan Ty dhe veprat që më afrojnë me dashurinë Tënde." (Tirmidhi, Deavat, 72/ 3490.)

Ahmet Tashgetiren: Ju theksuat pra që dashuria për Resulullahun, ﷺ, është djepi që rrit dashurinë Hyjnore.

Osman Nuri Topbash: Allahu i Lartmadhëruar në një ajet Kuranor urdhëron:

قُلْ اِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللّٰهَ فَاتَّبِعُونِى يُحْبِبْكُمُ اللّٰهُ
وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللّٰهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

"Thuaju (o Muhamed)**: 'Nëse ju e doni Allahun,**



atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë'." (Al- Imran, 31)

Zoti i Lartmadhëruar i drejtohet Profetit, ﷺ, me termin "I dashuri Im".

E nderoi atë me Miraxhin.

Ndërsa në lidhje me moralin e tij ka thënë:

وَاِنَّكَ لَعَلٰى خُلُقٍ عَظِيمٍ

"se ti je me virtyte madhore." (Kalem, 4)

Ahmet Tashgetiren: Në katin e Allahut ﷻ, Resulullahu, ﷺ, ka një vend të veçantë.

Osman Nuri Topbash: Ne as që mund ta imagjinojmë. Shfrytëzoj rastin të përmend një ngjarje që kalon në *Shifai Sherif*:

Një ditë teksa **Imâm Mâliku** ishte në mihrab, hyri në mesxhid kalifi i kohës, **Ebû Xhâfer Mansuri**. Ai bëri disa pyetje. Në mesin e tyre u zhvillua një diskutim intelektual. Mirëpo kur Ebu Xhafer Mensuri u përfshi aq shumë në debat sa filloi të ngrinte zërin, Imam Maliku i tërhoqi vëmendjen:

"-O Kalifi ynë! Ule zërin këtu! Qortimi i Allahut në lidhje me zërin e lartë u ka ardhur atyre që ishin edhe më të virtytshëm se ti."

Siç dihet në Kuranin Famëlartë thuhet:

"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të

lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare." (Huxhurat, 2)

Përballë kësaj edukate që shpalosej ndaj Resulullahut,ﷺ, Kalifi pyeti:

"-O Imam! Kur të bëj dua a të sillem nga Qabja e ndritur apo nga varri i nderuar i Profetit, ﷺ?"

Siç e dini, ithtarët e Vahabizmit nuk e lejojnë bërjen e duasë duke u drejtuar nga varri i Resulullahut, ﷺ.

Imam Maliku iu përgjigj:

"-Pse do ta heqësh fytyrën nga ai? Ai është për ty dhe për gjyshin tënd Ademin, një shkak ndërmjetësimi. Prandaj sillu nga Resulullahu, ﷺ, dhe kërko ndërmjetësimin e tij, që Allahu i Lartmadhëruar ta bëjë Resulullahun ﷺ ndërmjetësuesin tënd." (Shih. Kâdi Ijâz, Shifâ-i Sherîf, Bejrut 1404, v. II, s. 596)

Një gjeneral i famshëm osman, **Fahreddin Pasha**, një mbrojtës i shquar i Medinës, gjatë restaurimit të Ravzasë, u tha ustallarëve që morën përsipër këtë detyrë, që në rastin kur të lindte nevoja për të ngulur ndonjë gozhdë, të përdorej çekiç druri dhe të përdorej shajak ndërmjet tyre në mënyrë që të evitoheshin zhurmat, të cilat mund të shqetësonin shpirtin e Resulullahut, ﷺ.

Ahmet Tashgetiren: Osmanët kishin një dashuri të veçantë për Resulullahun, ﷺ, apo jo i nderuar?

Osman Nuri Topbash: Sigurisht, historia osmane është e mbushur me shembuj madhështorë dashurie ndaj Resulullahut, ﷺ.



EDUKATA E THIRRJES SË RESULULLAHUT

Në Epokën e Lumturisë disa nga sahabët e thërrisnin Resulullahun, ﷺ, me emër në formën "O Muhamed". Më pas u shpall ajeti 63 i sures Nur:


لَا تَجْعَلُوا دُعَاءَ الرَّسُولِ بَيْنَكُمْ كَدُعَاءِ بَعْضِكُمْ بَعْضًا

"Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit; Allahu, me siguri, i di ata që shkëputen prej jush tinëzisht. Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm." (Nur, 63)

Ibn Abbasi ﷺ në lidhje me ajetin në fjalë është shprehur:

"Njerëzit e thërrisnin Resulullahun në emër 'O Muhamed' apo 'o Ebul Kasim'. Allahu i Lartmadhëruar për ta nderuar të Dërguarin e Tij, e ndaloi këtë mënyrë të të thirrurit të tij. Pas kësaj njerëzit filluan ta thërrisnin atë 'O Resulullah (i Dërguari i Allahut)' ose 'O Nebijallah (Lajmëtari i Allahut)'. (Ebu Nuajm, Delail, I, 46.)

Kurani Famëlartë u drejtohet profetëve të tjerë edhe me emër, ndërsa **Resulullahut** në asnjë vend



nuk i drejtohet në formën 'O Muhammed'. Kurani Famëlartë i drejtohet atij në format 'O Nebi, o Resul'. Allahu i Lartmadhëruar i fton të gjithë besimtarët drejt kësaj edukate.

Ahmet Tashgetiren: Pra urdhërohet që mos të ulet Resulullahu në nivelin e njerëzve të tjerë.

Osman Nuri Topbash: Në suren Huxhurat Allahu i Lartmadhëruar na tërheq sërish vëmendjen:

"Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) **me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh."** (Huxhurat, 4)

Ajeti kërkon të na sqarojë mirë faktin se sa mirësi dhe bujari e pamatë nga Allahu ﷻ është për ne Resulullahu, ﷺ.

Se sa mirësi e madhe është festimi dhe gjallërimi i ditëlindjes së Resulullahut, ﷺ, kam dëshirë ta sqaroj me një histori të **Imam Kastalanit**... Ai është komentatori i famshëm i Buhariut. Ai transmeton:

Një natë xhaxhai i Resulullahut, **Ibn Abasi** رضي الله عنه, kishte parë në ëndërr vëllain e tij, **Ebu Lehebin**. Ai e kishte pyetur se në çfarë gjendjeje ishte dhe si po kalonte. Ibn Abasi, رضي الله عنه, i përkiste pjesës elitare të besimtarëve, ndërsa Ebu Lehebi përfaqësonte më të ultin e të poshtëruarve... Ai që përmendet si fatkeq edhe në suren Tebbet, pra Ebu Lehebi i ishte përgjigjur:

"Jam në xhehnem dhe po vuaj një dënim të rëndë. Mirëpo të hënave më lehtësohet shkalla e

dënimit. Kjo sepse kur skllavja im **Suvejbe** më solli lajmin e lindjes së nipit tim, Muhamedit, unë nga gëzimi që buronte prej lidhjeve farefisnore, i dhurova asaj lirinë."

Pra nëse një vepër bëhet për Resulullahun, ﷺ, edhe në rastin kur nijeti nuk është i saktë, nuk lihet pa shpërblim. Dijetari i madh i kiraatit dhe hadithit, **Ibnu'l Xhezeri** (833/1429), në lidhje me këtë ka thënë:

"Nëse një armik i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij, shpërblehet me lehtësimin e vuajtjeve vetëm për gëzimin që ka përjetuar me rastin e lindjes së Resulullahut, ﷺ, gëzim ky që ka buruar nga lidhja farefisnore me të, kushedi se çfarë shpërblimi do të fitojë një besimtar që në muajin e lindjes së Resulullahut, pra në muajin Rebiulevvel, e shpreh gëzimin e të qënit umeti i më të Dashurit të Allahut, me dhurim lëmoshe, organizime kuvendimesh, lexime Kurani dhe këndime ilahish."



A ËSHTË FESTIMI I DITËLINDJES SË RESULULLAHUT BIDAT?

Ahmet Tashgetiren: Prej këtu mund të kalojmë në pyetjen tjetër, i nderuar.

Hera-herës bëhen diskutime në lidhje me të qënit bidat apo jo të festimit të ditëlindjes së Resulullahut ﷺ. Bëhen pyetje të tilla si "A është kjo festë e bazuar në transmetime të sakta të islamit?" Pretendimit se festimi i ditëlindjes së Resulullahut ﷺ është bidat, çfarë mund t'i thoni?

Osman Nuri Topbash: Hixhreti bëhet fillimi i vitit, ndodh çlirimi i Mekës, Israja e Miraxhi pasohen me netë të mëdhaja. Këto janë ditë të cilat duhen bërë shkak për rritjen e atmosferës shpirtërore të besimtarit. Ceremonitë e festimit të ditëlindjes së Profetit, ﷺ, nëse bëhen siç duhet, pa u larguar nga thelbi dhe kuptimi, nuk mund të konsiderohen bidat.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për vizitën e varreve... Nëse ajo nuk bëhet siç duhet, kthehet në bidat.

Ahmet Tashgetiren: A mund ta zgjerojmë për sqarimin e mëtejshëm të lexuesve pjesën 'pa u larguar nga thelbi dhe kuptimi' zotëri? Çfarë duhet të kuptojmë me të?

Osman Nuri Topbash: Me shprehjen e mësipërme kuptoj përshtatshmërinë me normat e vyera të sheriatit dhe zbatimin e sahabëve të ndershëm. Pra nëse gjërat bëhen në përputhje me to, kemi ruajtje të thelbit dhe kuptimit të gjësë. Këtu kam dëshirë të jap një shembull:

Kur sahabët vërejtën së Resulullahu, ﷺ, kishte agjëruar në një ditë të hënë, e pyetën atë:

"-Pse po agjëroni, o i Dërguari i Allahut? Cila është urtësia e këtij agjërimi?"

Resulullahu, ﷺ, u dha atyre këtë përgjigje:


"(-Krahas shkaqeve të tjera) *Kjo është dita e ardhjes sime në këtë botë.*" (Shih. Muslim, Sijâm, 1162.)

Resulullahu, ﷺ, ka lindur ditën e hënë. Atij iu dha profecia ditën e hënë. Ditën e hënë emigroi nga Meka për në Medinë. Arritja e tij në Medinë ndodhi të hënën. Ditën e hënë bëri gjykatësin pranë Qabes dhe vendosi aty Gurin e Zi. Ditën e hënë fitoi luftën e Bedrit. Sërish në ditën e hënë u shpall ajeti:

اَلْيَوْمَ اَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَاَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي
وَرَضِيتُ لَكُمُ الْاِسْلَامَ دِينًا

"...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj..." (Maide, 3)

Pra Islami u përsos dhe u kompletua ditën e



hënë. Dhe ditën e hënë ndërroi jetë i Dashuri i Allahut, ﷺ.

Të gjitha këto ngjarje të shënuara që ndodhën në ditën e **hënë**, pra ditëlindja, profecia, hixhreti, dhe ndërrimi i jetë i Resulullahut, ﷺ, shënjojnë edhe shenjtërinë e kësaj dite.

Ahmet Tashgetiren: Pra Resulullahu ﷺ e ka vlerësuar ditën e hënë duke e agjëruar atë.

Osman Nuri Topbash: Po, e ka vlerësuar dhe në shenjë falënderimi e ka agjëruar atë ditë...

Në lidhje me agjërimin e ditëlindjes së Resulullahut, ﷺ, ka dy qëndrime dhe për mendimin tim të dyja janë të sakta.

Qëndrimi i parë. Duhet agjëruar. Sepse vetë Pejgamberi ﷺ e ka agjëruar këtë ditë duke i dhënë një rëndësi të veçantë.

Si rezulatat, çdo besimtar mund ta agjërojë këtë ditë në shenjë falënderimi për të qënit umet i Resulullahut, ﷺ. Pra duke menduar "Allahu i Lartmadhëruar më nderoi me mirësinë më të madhe. Të qënit umet i Resulullahut ﷺ është një mirësi e pamatë për fitimin e përjetësisë sime!", ai mund të agjërojë për mirënjohjë dhe falënderim. Ky veprim është i preferuar dhe i bukur.

Ahmet Tashgetiren: Për ta falënderuar Atë. Mbahet agjërimi për t'i thënë Zotit "Sa mirë që ma bëre rrisk këtë të mirë, o Zoti im!"

Osman Nuri Topbash: Një pjesë tjetër e dije-

tarëve e mendojnë ditën e lindjes së Resulullahut, ﷺ, si ditë bajrami. "Në ditën kur kjo dynja nderohet me praninë e Resulullahut, ﷺ, na duhet të shtojmë falënderimin dhe mirënjohjen" mendojnë ata. Kështu ata i shohin si të preferuara veprat e mira si dhënien e lëmoshës, gëzimin e fukarait, leximin e kasideve, ilahive etj.. Mirëpo siç e dimë në ditë bajrami nuk është e këshilluar të agjërohet.

Ahmet Tashgetiren: Pra është e lejuar edhe të agjërohet, por edhe të mos agjërohet...


Osman Nuri Topbash: Është bukur edhe të agjërohet por edhe të mos agjërohet në ditën në fjalë.

Ahmet Tashgetiren: Në të dyja rastet kemi të bëjmë me qëndrime që shprehin robërinë ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe që ushqejnë devotshmërinë (takavanë).

Osman Nuri Topbash: Sigurisht, asnjëri nuk mund t'i thotë tjetrit "Pse agjëron në këtë ditë? Është bidat!" Sepse ashtu siç u shprehëm më sipër, vetë Resulullahu, ﷺ, e ka agjëruar.

Nga ana tjetër ata që shtojnë veprat e mira të sadakasë dhe shërbimit në këtë ditë të cilën e konsiderojnë si ditë bajrami, bëjnë një gjë shumë të bukur duke shprehur mirënjohje dhe falënderim ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

Ahmet Tashgetiren: Duhet bërë çështje e ditës Mevludi apo ditëlindja e Resulullahut ﷺ edhe në fushën e meditimit e reflektimit. Çfarë



duhet të mendojmë dhe si duhet të thellohemi në meditim gjatë kësaj feste? Si mund ta përcjellim këtë ditë të lindjes së Resulullahut, ﷺ, ditë që Allahu i Lartmadhëruar zgjodhi për të na dërguar më të dashurin e Tij, me persiatje? Si duhet të na ndezë reflektimi, meditimi e persiatja në këtë ditë në mënyrë që ta mbruajmë gjithë vitin me dashurinë e Resulullahut, ﷺ?

Osman Nuri Topbash: E gjithë përpjekja jonë e meditimit duhet të bëhet në drejtim të dashurimit të Resulullahut, ﷺ. Për shembull tekstet e mevludeve janë në fakt historia e Profetit. Janë shkruar ndoshta me qindra tekste mevludesh, por ai që gëzon një vend të veçantë në mesin e tyre është padyshim mevludi i **Sulejman Çelebisë**. Kur përmendet fjala mevlud na shkon në mendje menjëherë Sulejman Çelebiu. E ka shpjeguar jetën e Resulullahut ﷺ me aq sinqeritet e emocion sa mevludi i tij ruan freskinë përgjatë shekujve.

Ahmet Tashgetiren: Edhe pjesa e lindjes, edhe e Miraxhit?

Osman Nuri Topbash: Po. Për shembull në vargjet:

Kur krijoi Zoti i Madh Ademin,
Zbukuroi me të, gjithë alemin! (botën)

Ai thekson faktin që Ademi dhe dynjaja u krijuan me një qëllim;

Ndërsa në disa vargje të tjera ai shprehet se

edhe dielli i dalldisur sillej si flutur rreth nurit të Resulullahut, pra edhe jofrymorët kishin rënë në dashuri me të.

Në kohën e osmanëve kur këndoheshin vargjet e lindjes së Resulullahut ﷺ, për ta respektuar atë, ishte zhvilluar një traditë e bukur e ngritjes në këmbë për ta mikpritur praninë e tij.



NJERIU ËSHTË ME ATË QË DO

Ahmet Tashgetiren: Në temën e meditimit ju vini theksin e vëmendjes në një hadith fisnik.

اَلْمَرْءُ مَعَ مَنْ أَحَبَّ

"Njeriu është me atë që do." (Buhârî, Edeb, 96.)

Me siguri, me hadithin e mësipërm duhet ta fillojmë udhëtimin e meditimit. Pra njeriu është me atë që do. Ku është me atë që do? Mos duhet menduar kjo në këtë formë:

Theubani ﷺ, për të qënë bashkë me Resulullahun ﷺ në ahiret, bënte plane vazhdimisht sa ishte në jetën e kësaj bote apo jo zotëri?

Osman Nuri Topbash: Theubani ﷺ siç duket e kishte përjetuar kënaqësinë e të qënit bashkë me Resulullahun, ﷺ, prandaj e dëshirontë këtë gjë edhe në botën tjetër. Kënaqësia e qëndrimit me Resulullahun ﷺ ishte e pakrahasueshme me diçka tjetër për të...

Kur sahabët ndodheshin në kuvendimet e Resulullahut, ﷺ, dashurinë, nderimin dhe edukatën që kishin për të, e shfaqnin në formën:

"Qëndronim pa lëvizur pranë Resulullahut, ﷺ,

sikur mbi kokat tona të kishte zogj që mund të trembeshin e të iknin."

Çfarë është kjo? Kjo është një gjendje e jashtëzakonshme e marrjes së kënaqësisë shpirtërore. Një kënaqësi me të cilën njeriu nuk ngopet kurrë. Sikur sahabët të mos merrnin kënaqësi të madhe shpirtërore nga Resulullahu, ﷺ, nuk do të përjetonin gjëndje aq të larta në kuvendimet e tij.

Theubani ﷺ e kishte përjetuar një kënaqësi të tillë nga Resulullahu, ﷺ, prandaj i vinte e papërballueshme ndarja me të.


Një ditë Resulullahu ﷺ e pa Theubanin ﷺ të mërzitur dhe e pyeti:

"-O Theuban! Çfarë ke? Çfarë të shqetëson kaq shumë?"

Theubani me zemrën e mbushur me dashuri u përgjigj:

"-O Resulullah! Kur jam i pranishëm në kuvendimet tuaja, ndihem i mbushur plot me dashuri për ty, e kur shkëputem prej këtu e shkoj në shtëpi, ndihem i vetmuar e më merr malli për ty. Po në Ditën e Kiametit çfarë do të bëhet me mua? Ku do të flakem vallë? Ju do të jeni në gradën më të lartë të profecisë. Kurse mua nuk di çfarë do të më gjejë. Ky shqetësim po më mundon shumë!"

Sipas një transmetimi në këtë hadith, e sipas një transmetimi tjetër në një tjetër hadith, Resulullahu ﷺ ka thënë: *"Njeriu është me atë që do."* (Buhari, Edeb, 96.)



Kjo do të thotë që kënaqësia shpirtërore që merrnin sahabët nga kuvendimet me Resulullahun, ﷺ, kishte arritur në nivele aq të larta, saqë largimi dhe shkëputja prej aty bëhej e papërballueshme dhe burim trishtimi që shkaktohej nga malli.

Ahmet Tashgetiren: Po ne si dhe ku do ta gjejmë këtë kënaqësi shpirtërore i nderuar?

Osman Nuri Topbash: Ajo fillon duke vënë kokën në prag si Junusi. Shembujt e miqve të Allahut janë të ngjashëm në vështirësitë dhe vuajtjet që kanë hequr në këtë rrugë. Për shembull **Abdullah Dehlevîu** e urdhëroi **Hâlidi Bagdadîn** që të pastronte tualetet ndërkohë që ai pritej gjithkund me komplimente e nderime.

Aziz Mahmud Hydaji, kadiu më i nderuar i Bursës, urdhërohet që të dalë me togën e tij të zbukuruar të shesë mëlçi rrugicë më rrugicë. Në fillim ai shet mëlçi, por më pas bëhet udhëheqësi shpirtëror i sulltanëve më të shquar që drejtuan botën. Ja pra, ai nuk do të bëhej i tillë pa shitur mëlçi me qëllimin e edukimit të egos.

Nëse do të bëhej një vëzhgim i kujdesshëm, do të vërehej qartë se këto veprime kultivojnë dorëzimin dhe edukojnë nefsin. Kënaqësia për të cilën më pyetët, nuk mund të arrihet pa dorëzim të plotë, pa modesti, pa edukimin e nefsit. Në fillim duhet kapërcyer qenia.

Ahmet Tashgetiren: Po prej aty si mund të shkohet te Resulullahu ﷺ? E zëmë se Aziz

Mummud Hüdajî kaloi në një proces të tillë edukimi, Hâlid-i Bağdadî dhe Jûnus Emre e vunë kokën në pragun ku shkel gjthkush, po prej aty si arrihet te dashuria e flaktë për Resulullahun, i nderuar?

Osman Nuri Topbash: Nëse do të reflektonim mirë në ajetin e mëposhtëm, do ta gjenim edhe përgjigjen e pyetjes që më shtruat. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا وَتَقْوٰيهَا

"Duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën!" (Shems, 8)

Pra në fillim duhet bërë largimi nga gjynahu dhe nga e keqja, e mandej duhet të lehtësohet, të pastrohet e të purifikohet zemra. Duhet mbyllur kapitulli i **"La ilahe"-**së. Që do të thotë që zemra duhet të largohet nga çdo gjë që e largon atë nga Allahu i Lartmadhëruar. Nuk duhet të na mbesë asnjë idhull pa u thyer brenda qenies sonë. Duhet të shkëputemi nga tekat e kapriçot tona.

Më pas zemra do të shijojë **"il-lallah"-**un, do të fillojë të qëndrojë bashkë me Allahun e Lartmadhëruar e do të përjetojë manifestimet e cilësive të bukura të Tij. Do të arrijë në gradën e thënies me vetëdije "Vetëm ti je, o Allahu im!".

Në vazhdimin e ajetit që përmendëm më lart, Allahu i Lartmadhëruar urdhëron:

قَدْ اَفْلَحَ مَنْ زَكّٰيهَا

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë.” (Shems, 9)

Edhe tek Pejgamberët madje, nëse mund të shprehemi kështu, është zbatuar kjo praktikë, fillimisht është bërë pastrimi i botës së tyre të brendshme. Pasi është arritur kjo, është parë i përshtatshëm dhurimi i shpalljes. Libri apo shpallja fillonte t’i zbriste një zemre të pastër, të rafinuar e të purifikuar. Më pas realizohej thellimi në Kuran dhe formohej urtësia.

Urtësia fillon aty ku mendja pranon pamundësinë e saj. Më pas në zemër shpaloset pjesa e fshehtë e objekteve, ngjarjeve e ndodhive. Atëherë shtohet dashuria vazhdimisht. Këtu fillon njohja e Allahut të Lartmadhëruar.

Kjo gjendje te sahabët ishte në maksimumin e saj. Për shembull, kur zbriti ajeti i mbulesës, të gjithë morën mbulesat e shtëpisë, i prenë dhe i bënë mbulesa për kokën. E çfarë tjetër ishte kjo veç dorëzimit?! Këto janë shfaqjet e dashurisë që ata kishin.

Resulullahu ﷺ e donte fort Kuranin Famëlartë, e po kaq fort e donin edhe sahabët e nderuar.

Kur zbriste ndonjë ajet nga Allahu i Lartmadhëruar, ata e konsideronin atë si një sofër të zbritur nga qielli. Pyesnin me shumë interes se cili ishte qëllimi

i Allahut ﷻ me shpalljen e ajetit në fjalë. Ata përpiqeshin vazhdimisht që nëpërmjet këtij interesimi të fitonin kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar. Kur sahabët shkonin në shtëpi, gratë e tyre sahabe pyesnin:

"-Çfarë ajeti zbriti sot nga Allahu i Lartmadhëruar? Çfarë hadithesh e fjalësh të ëmbla dolën nga goja e bukur e Resulullahut, ﷺ?"

Kur ato përcillnin bashkëshortët e tyre për në punë, u thoshin:

"-Ruhuni që të mos na sillni asnjë kafshatë haram në shtëpi! Ne i bëjmë ballë urisë, por jo zjarrit të xhehnemit!"

E çfarë tregojnë këto veprime veç dashurisë që ato kishin për Resulullahun, ﷺ, shkrirjen që ato kishin me gjendjet e tij!

Sa më shumë afrohet besimtari me Modelin më të përsosur, Zotërinë tonë, Resulullahun, ﷺ, aq më shumë shtohen meditimet, reflektimet e frymëzimet e zemrës...



ISLAMI ËSHTË EKSPOZUAR NË PERSONALITETIN E RESULULLAHUT

Ahmet Tashgetiren: Atëherë Mevludi duhet të shërbejë si shkak për të bërë llogarinë e të gjithave sa përmendem më lart apo jo, i nderuar? Çfarë raporti kemi ne me Resulullahun ﷺ? Çfarë raporti kemi ne me Kuranin Famëlartë, po me Allahun Fuqiplotë? Duhet t'i bëjmë thellë brenda nesh këto llogari!

Osman Nuri Topbash: Po. Ne, fenë e Allahut e mësojmë nëpërmjet Resulullahut, ﷺ. Veç kështu mund ta perceptojmë atë. Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin Famëlartë urdhëron:

نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْاَمِينُ ﴿١٩٣﴾ عَلٰى قَلْبِكَ لِتَكُونَ
مِنَ الْمُنْذِرِينَ ﴿١٩٤﴾ بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُبِينٍ ﴿١٩٥﴾

"Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili)**, në zemrën tënde** (o Muhamed) **që të jesh nga ata që paralajmërojnë."** (Shuara, 193-195)

Pra Kurani Famëlartë u komentua në zemrën e Resulullahut, ﷺ, për 23 vjet. Siç e përmendëm edhe më lart, ka një grup njerëzish -Allahu na ruajt prej sherrit të tyre- që i thonë umetit të hz. Muhamedit,


"Ne na mjafton Kurani, nuk kemi nevojë për Sunetin e Resulullahut(!)"

Kurani i madhërishëm zbriti në një hark kohor prej 23 vitesh dhe çdo ajet u konkretizua nga Resulullahu, ﷺ. Ne, rekatët e namazeve, formën e namazit, rregullat e tjera të fesë i mësojmë nëpërmjet Resulullahut, ﷺ. Pjesën e jashtme të fesë, por edhe atë të brendshme, i mësojmë nga Resulullahu, ﷺ.

Për shembull, pjesën e jashtme të namazit, formën e faljes së rekatëve, se çfarë duhet kënduar në kijam, ruku, sexhde e tehijjatu, si duhet të ulemi e ngrihemi i kemi mësuar të gjitha nga ai ﷺ. Ashtu siç kemi mësuar pjesën formale nga Resulullahu, ﷺ, kemi mësuar edhe pjesën shpirtërore të saj prej tij ﷺ. Resulullahu, ﷺ, ka thënë: "Faleni namazin siç më shihni mua duke e falur!" (Buhârî, Edhân, 18.)

Në lidhje me këtë temë, dua të jap një shembull; Ngrënia e mishit të ngordhur a është haram sipas Kuranit? Mirëpo ne e hamë peshkun, i cili është mish i ngordhur. Kjo përforcon idenë dhe mendimin se ne i mësojmë dhe kuptojmë gjërat vetëm nëpërmjet Resulullahut ﷺ.

Në ajetin kuranor thuhet مَنِ اسْتَطَاعَ / **"Për këdo që ka mundësi."** (Al Imran, 97). Nga kush duhet ta mësojmë ne objektin e mundësisë? E kuptojmë nga aplikimet e Resulullahut, ﷺ. Pikëpamjet apo konkluzionet juridike islame përftohen duke u mbështetur tek aplikimet e Resulullahut, ﷺ. Sikur



të mos ishin aplikimet e Resulullahut ﷺ, edhe sikur ne të përpiqeshim të gjenim rrugën vetëm nëpërmjet interpretimeve, kjo do të përbënte një rrugë të hapur për abuzim, e kështu ne do të binim në kundërshti me njëri-tjetrin duke u përçarë e dobësuar...

Ahmet Tashgetiren: I nderuar, ne besojmë te Kurani nëpërmjet cilësisë së Resulullahut ﷺ "el Emin". Tekefundit Kurani Famëlartë na erdhi nëpërmjet tij ﷺ.

Osman Nuri Topbash: Po. Në një ajet kuranor thuhet:

مَنْ يُطِعِ الرَّسُولَ فَقَدْ اَطَاعَ اللهَ

"Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut..." (Nisa, 80)

Gjithmonë bindja ndaj Resulullahut, ﷺ, është bindje ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

Në një tjetër ajet Allahu i Lartmadhëruar urdhëron:

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوٰى

"Ai nuk flet sipas qejfit të vet." (Nexhm, 3)

Prandaj themi që, të mendosh se Kurani është i mjaftueshëm e të përçmosh Sunetin e Resulullahut, ﷺ, është një fatkeqësi shumë e madhe.


BRAKTISJA E SUNETIT SHKAKTON DOBËSIMIN E FESË

Ahmet Tashgetiren: Ata shprehen: "Ju nuk keni respektin dhe ndjeshmërinë e duhur për Kuranin Famëlartë, ju vendosni para Kuranit Resulullahun, ﷺ. Ne dëshirojmë që të vendosim Kuranin Famëlartë para Resulullahut, ﷺ." T'i japësh rëndësinë që i takon Resulullahut ﷺ nuk do të thotë të neglizhosh apo përçmosh Kuranin Famëlartë. Kurani Famëlartë me Resulullahun ﷺ janë në një raport shumë të ngushtë, prandaj duhen gërshetuar.

Osman Nuri Topbash: Komenti i Kuranit Famëlartë është Resulullahu, ﷺ. Komentatori më kompetent i Kuranit është Resulullahu ﷺ. Edhe fjalët, por edhe veprat e gjendjet e tij ﷺ janë komentim i Kuranit Famëlartë.

Abdullah ibn Dejlemi e shpreh lidhjen e fortë që duhet të ketë besimtari me sunetin kështu:

"...Shkatërrimi (humbja e forcës) i fesë do të fillojë me lëshimin e sunetit. Ashtu siç këputet litari duke iu këputur fijet një e nga një, ashtu edhe feja shuhet me braktisjen e suneteve një e nga një." (Dârimî, Mukaddime, 16)



Nga historia e feve mesojme faktin që hebraizmi dhe krishterimi janë shtrembëruar pikërisht në këtë formë. Fillimisht janë braktisur praktikat e profetëve e më pas janë manipuluar bazat e besimit dhe adhurimet.

Është braktisur **namazi** dhe vendin e tij e kanë zënë **ritualet**, është lënë **agjërimi** duke u zëvendësuar me **privimet (dietat)** e ndryshme, është shmangur **mbulesa** duke u lejuar veç për murgeshat, madje sot bëhet përpjekje që të hiqet edhe tek ato.

Ahmet Tashgetiren: Kur hiqet suneti nga jeta e besimtarit, atëherë një pjesë e rëndësishme e personalitetit të myslimanit rrëzohet e shuhet apo jo i nderuar?

Osman Nuri Topbash: Allahu i Lartmadhëruar në një hadith kudsi ka thënë:

"... Robi nuk mund të më afrohet Mua më shumë se me veprat obligative (farz)*. Ai më afrohet Mua vazhdimisht me veprat nafile* (si shtesë të farzeve)*. Derisa Unë e dua atë. Pasi Unë ta dua atë, bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin sheh, dora e tij me të cilën mban, këmba e tij me të cilën ec, zemra e tij me të cilën mendon dhe gjuha e tij me të cilën flet."* (Shih. Buhârî, Rikāk, 38; Ahmed, VI, 256; Hejsemî, II, 248.)

Siç kuptohet nga hadithi i mësipërm, afrimi me Allahun e Lartmadhëruar realizohet me njohjen e Resulullahut, ﷺ, duke kryer farzet e nafilet, pra duke zbatuar Sunetin e tij.

Ahmet Tashgetiren: Kur themi nafile, kuptojmë të gjitha veprimet e Resulullahut ﷺ duke përjashtuar farzet?

Osman Nuri Topbash: Po. Krijesa më e dashur për Allahun e Lartmadhëruar është Resulullahu ﷺ. Natyrshëm që Allahu i Lartmadhëruar do shumë edhe ata që e duan më të dashurin e Tij. Ju kur doni dikë shumë, respektoni e doni edhe të dashurit e tij. Kjo është një gjë krejt normale.


Ahmet Tashgetiren: Ndjej sikur nuk vlerësohet sa duhet apo injorohet pozita e Resulullahut ﷺ, te Allahu i Lartmadhëruar.

Osman Nuri Topbash: Fatkeqësisht po. Njëri nga hadithet që flet për vlerat e Resulullahut është edhe ky:

Një ditë sahabët po flisnin me njëri-tjetrin. Po bisedonin të çuditur e të mahnitur në lidhje me faktin se Allahu i Lartmadhëruar zgjodhi nga mesi i njerëzve **Ibrahimin,** عليه السلام, si mik të Tij, **Musain,** عليه السلام, për të folur me të, **Isain,** عليه السلام, për fjalë dhe shpirtin e Tij dhe **Ademin,** عليه السلام, të përzgjedhurin e Tij. Ndërkohë Resulullahu ﷺ erdhi pranë tyre dhe i dëgjoi çfarë folën. I Dërguari i Allahut u shpreh:

"-Po, ashtu siç thatë është!" Më pas përmendi cilësitë e tij duke u shprehur:

"Unë jam zotëria i të gjithë profetëve, por nuk po e them këtë për t'u lavdëruar (pasi kjo nuk lejohet). Unë jam profeti i fundit, por nuk



po e them këtë për t'u lavdëruar. Unë do të jem ndërmjetësuesi i parë dhe i pari të cilit do t'i pranohet ndërmjetësimi, por kurrë nuk e them këtë për t'u lavdëruar." (Dârimî, Mukaddime, 8.)

"Në ditën e kiametit, kur të hapet toka, unë do të jem i pari që do të ringjallem, por nuk po e them këtë për t'u lavdëruar. Flamuri i falënderimit do të më jepet mua, por këtë nuk po e them për t'u lavdëruar. Në ditën e kiametit do të jem zotëria i të gjithë njerëzve, por nuk po e them këtë për t'u lavdëruar. I pari që do të hyjë në xhenet në ditën e kiametit do të jem unë, por këtë nuk e bëj shkak për t'u lavdëruar." (Dârimî, Mukaddime, 8. Gjithashtu shih. Tirmidhî, Menâkib, 1/3616.)

Resulullahu ﷺ i ka tërhequr vëmendjen **Abdullah ibn Omerin** رضي الله عنه që donte aq shumë:

"O Ibn Omer! Lidhu fort me fenë tënde! Tekefundit ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Ki kujdes shumë se prej kujt e mëson fenë. Dituritë dhe dispozitat fetare merri nga dijetarët e qendrueshëm të fesë e jo nga ata që luhaten sa majtas e djathtas." (Hatîb el-Bagdâdî, el-Kifâje fî Ilmi'r-Rivâje, el-Medînetu'l-Munevvere, el-Mektebetu'l-Ilmijje, fq. 121)

Ja pra këto janë standarde shumë të rëndësishme.

Ahmet Tashgetiren: Këshilla shumë të vlefshme profetike për të gjitha kohët.


Osman Nuri Topbash: **Abdulehad Dâvûd Efendiu** është një nga dijetarët e përkushtuar të

fesë. Ai kishte studiuar dhe analizuar kopjet më të vjetra të biblës, madje edhe fletushkat e krishtërimit. Ai shprehet: "E vërteta e krishterimit u shua në tre etapa. Në fillimet e veta krishterimi kishte sunetin (aplikimet) e Isait, por me pas ai u lëshua dhe në vendin e tij u vendos pagëzimi. Së dyti, kishte namazin që u zëvendësua me ritualet. Dhe së treti kishte agjërimin që u zëvendësua me mbajtjen e pehrizës." Latim pas latimi shuhet krejt feja.

Ahmet Tashgetiren: Pra duhet kushtuar shumë kujdes ndaj standardeve hyjnore.

Osman Nuri Topbash: Kur braktiset Suneti i Resulullahut, ﷺ, humbasin edhe standardet hyjnore -Allahu na ruajt-. Kjo është një fatkeqësi shumë e madhe. Një tjetër fatkeqësi na serviret nga ata që kanë pranuar historicizmin si të vetmen dritare të interpretimit të Islamit. Sunetin e nderuar të Resulullahut ﷺ e konsiderojnë si shumë të vlefshëm vetëm për kohën kur ka jetuar i Dërguari i Allahut, ﷺ, kështu përpiqen ta vjetërojnë e ta dobësojnë Islamin. Më pas këta trajtojnë me të njëjtin këndvështrim ato ajete të Kuranit prej të cilave përftohen dispozitat e Islamit. Kështu ata nxjerrin prej funksionit shumë ajete të Allahut të Lartmadhëruar. Fundi i kësaj fatkeqësie -Allahu na ruajt- e shpie njeriun në kufër. Kjo padyshim është lojë me zjarrin.

Fundi i një punë ku përzihen tekat dhe kapriçot, e më pas egoja e mendjemadhësia, është padyshim humbja e shkatërrimi. E në të njëjtën kohë ata do



të mbajnë përgjegjësinë edhe të atyre që u shkojnë pas.

Ahmet Tashgetiren: Atëherë i nderuar, në këtë Mevlud, gjatë festimit të këtyre ditëve të lindjes së Resulullahut ﷺ, duhet të shohim mirë se nga burojnë distancimet nga Resulullahu ﷺ, e përçarjet e ndryshme.

Osman Nuri Topbash: Allahu i Lartmadhëruar në librin e Tij urdhëron:

وَمَا اٰتٰيكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهٰيكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا
وَاتَّقُوا اللّٰهَ اِنَّ اللّٰهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ

"Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër." (Hashr, 7)

يَا اَيُّهَا الَّذِينَ اٰمَنُوا اَطِيعُوا اللّٰهَ وَاَطِيعُوا الرَّسُولَ
وَلَا تُبْطِلُوا اَعْمَالَكُمْ

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!" (Muhamed, 33)

Resulullahu, ﷺ, ka thënë:

"Umeti im do të ndahet në shtatë dhjetë e tre grupe." (Tirmidhî, Îman, 18; Ibn Mâxhe, Fiten, 17.)

Kjo mund të jetë shprehur në mënyrë të saktë,

por edhe në mënyrë simbolike. Kur i hedhim një sy umetit në kohën tonë, shohim disa grupe që janë shkëputur e ndarë. Ata janë shkëputur nga Suneti i Resulullahut ﷺ, e e interpretojnë Islamin sipas qejfit të tyre. U mungon shpirtërorja, ky është problemi i tyre.

Kur në fakt gjendjet, aplikimet e veprimet e Resulullahut, ﷺ, janë komenti më i saktë i çdo ajeti kuranor. Këto u skalitën në zemrat e mendjet e sahabëve të nderuar. Kështu sahabët kaluan një edukim të mirëfilltë historie profetike. Përfunduan me sukses nxënien e jetës së Resulullahut, ﷺ, për 23 vite më radhë. Ata nuk mësuan historinë e Resulullahut, ﷺ, në formë kronologjike e akademike. Fatkeqësisht sot, jeta e Resulullahut ﷺ, mësohet vetëm në mënyrë kronologjike.

Ahmet Tashgetiren: Pra ata e jetuan atë nga brenda, jo nga jashtë e si spektatorë.

Osman Nuri Topbash: E jetuan historinë me gjendje. Morën energjinë nga Resulullahu, ﷺ, dhe jetuan me të.



SI DUHET TË ZHVILLOHET LËNDA E HISTORISË SË RESULULLAHUT

Ahmet Tashgetiren: Në rregull i nderuar, po si duhet të realizohet sot lënda e historisë së Resulullahut, ﷺ?

Osman Nuri Topbash: Fatkeqësisht sot lënda e historisë së Profetit jepet thjeshtë si kronologji ngjarjesh.

Në gjykimin tim mësuesit e kësaj lënde kaq të rëndësishme, duhet të jenë shumë të devotshëm. Duhet t'i kenë zemrat e gjalla e të frymëzuara. Ashtu siç buzëqesh njeriu nga qetësia e bukuria, kur sheh ujin që rrjedh apo natyrën e gjelbër, ashtu edhe mësuesit e lëndës së historisë së Resulullahut, ﷺ, duhet ta shpjegojnë lëndën me dashuri e mall për më të bukurin e krijesave. Kështu dashuria e tyre do të emetohet edhe tek nxënësit e tyre. Mirëpo sot fatkeqësisht kjo lëndë shpjegohet e thatë dhe thjeshtë si kronologji. Poeti i madh **Fuzuli** ishte pajisur me aq dituri të thella në lidhje me historinë e Resulullahut, ﷺ, sa në çdo gjë shihte vetëm atë, edhe në rrjedhën e ujit madje... Sa të bukura janë vargjet:

"Uji, për të arritur dheun e shkelur nga Resulullahu ﷺ, çdo çast, pa u ndalur, (duke qënë i dehur

me dashurinë ndaj Resulullahut) si një ashik endacak, (prej dhimbjes së ndarjes) duke përplasur kokën gurë më gurë (duke qare pa pushim) rrjedh (drejt tij)."

Ahmet Tashgetiren: Kronologji, në këtë datë u zhvillua kjo luftë e kështu me radhë...

Osman Nuri Topbash: Kështu mund të zhvillohet historia e të tjerëve, por jo e Resulullahut ﷺ. Ajo është tjetër gjë. Ajo duhet të ketë atmosferë shpirtërore. Ata që e perceptojnë dhe e kuptojnë siç duhet jetën e Resulullahut, ﷺ, janë padyshim evlijatë e Allahut.


Ahmet Tashgetiren: E si duhet ta kuptojmë këtë i nderuar? Duhet bërë zhvillimi dhe leximi i lëndës sikur ai është akoma gjallë e në jetë?

Osman Nuri Topbash: Kam dëshirë të jap sërish shembullin e hijes dhe besnikërisë së saj ndaj të zotit. Hija nuk shkon në një anë e i zoti i saj në anën tjetër, pra ajo kurrë nuk ndahet nga i zoti. Kështu ishin edhe sahabët me Resulullahun, ﷺ. Ata kurrë nuk u ndanë prej tij. Edhe evlijatë e Allahut këtë u përpoqën të bënin.

Ahmet Tashgetiren: Pra ata ishin si hija e Resulullahut, ﷺ?

Osman Nuri Topbash: Ata ishin hija e Resulullahut, ﷺ. -Kështu e ka bërë Resulullahu, ﷺ, - thoshin ata, e përpiqeshin ta bënin edhe vete të njëjtën gjë.

Imam Neveviu, gjatë gjithë jetës së tij nuk ka ngrënë shalqi sepse nuk kishte gjetur asnjë trans-



metim në lidhje me faktin se si e kishte prerë e se si e kishte ngrënë Resulullahu, ﷺ, shalqirin. Shalqiri që freskon çdokënd, atë nuk e freskoi dot sepse ai nuk e dinte se si e kishte ngrënë Resulullahu ﷺ.

Sejjid Ahmet Jeseviu, kur mbërriti në moshën 63 vjeçare, e shtyu jetën nën tokë në një qilar apo bodrum të ngjashëm me varrin. Nëse do ta bënim ne këtë, do të ishtë syfaqësi. Ai ishte i dashuruar aq shumë me Resulullahun, ﷺ, saqë jetoi rreth 10 vjet nën tokë prej ku kreu edhe detyrën e udhëzuesit.

Kurse nga sahabët e nderuar, Abdullah ibn Zejd el Ensari رضي الله عنه, teksa po punonte në bahçen e tij, mori lajmin nga i biri, i cili erdhi drejt tij duke vrapuar e plot trishtim, se Resulullahu, ﷺ, kishte ndërruar jetë, i tronditur bëri këtë lutje:

"O Zoti im! M'i merr sytë në këtë çast që mos të shoh më askend tjetër veç Resulullahut ﷺ."

Duaja e tij u pranua dhe ai u verbua në çast.

E rëndësishme është që kur të shohim fenë, mos të na shtrembërohen sytë, mos ta shohim vëngër fenë. Këta që shprehen; "Ne na mjafton Kurani", bëjnë sikur kanë lexuar historinë e Resulullahut, ﷺ, dhe e kanë shteruar atë. Kur në fakt lënda më e vështirë është historia e Resulullahut, ﷺ. Sepse çështja e historisë së Resulullahut është çështje gjendjesh. Nëse ke lexuar historinë e Resulullahut ﷺ, por nuk ke vënë asgjë në zbatim, atëhere kjo do të thotë që nuk ke lexuar asgjë nga jeta e tij.

Ahmet Tashgetiren: Nëse në këtë ditë të veçantë do t'u jepnim një mesazh familjeve... Ta jetojnë klimën e Resulullahut, ﷺ, në shtëpi me nënat, baballarët, fëmijët, evladët...

Osman Nuri Topbash: Leximi i historisë së Resulullahut ﷺ në shtëpi, një ditë të caktuar të javës, do t'u bënte shumë mirë fëmijëve.


Nëse duam fëmijë pa të meta atëherë duhet të bëhemi prindër pa të meta. Prej fëmijëve do të marrim atë çfarë u japim. Sa bukur e shpreh **Rumiu** në vargjet e veta këtë të vërtetë:

"A të ka ndodhur ndonjëherë që të mbjellësh grurë e të korrësh elb?!"

Përgjegjësia konkrete këtu u bie prindërve. Sepse ata që vinë pas, imitojnë e ndjekin me admirim ata që kanë përpara. Fillimisht vetë prindërit duhet ta kenë në zemër Resulullahun, ﷺ. I Dashuri i Allahut duhet të përmendet e të aktualizohet çdo ditë në shtëpi. Gjatë ngrënies, shtrirjes për të fjetur, gjatë zgjimit e lutjeve. Prindërit duhet të përfaqësojnë vetë këtë gjendje. Pra veprimet e tyre duhet të jenë në zbatueshmëri të plotë të sunetit të nderuar të Resulullahut, ﷺ.

Duhet t'u shpjegohet në mënyrë të vazhdueshme e me buzëqeshje fëmijëve Resulullahu, ﷺ. Atyre duhet t'u serviren shembuj nga personaliteti i tij ﷺ:

"Ki kujdes! Resulullahu, ﷺ, nuk do të donte që ti ta bëjë këtë veprim, do të mërzitej shumë po



ta shihte!"

"Ti e ke thënë shehadetin me dëshirën tënde, i Dërguari i Allahut i donte shumë fëmijët, luante vazhdimisht me ta. Po ta shihte veprimin tënd të bukur që bëre, kushedi sa shumë do të të përqafonte. Ti vazhdo ta bësh këtë veprim që në jetën tjetër të pasosur, ai ﷺ, të të përqafojë e të të mbajë afër vetes."

Kështu duhet t'i ndikojmë fëmijët me të mirë e me dashuri. Padyshim ata fëmijë që këshillohen nga prindërit, duhet të shohin praktikisht te prindërit e tyre këshillën e dhënë. Nëse fëmijët do të shihnin Sunetin e Resulullahut të mishëruar te prinderit e tyre, atëhere nuk do të kishte nevojë më për fjalë të shumta.

Ahmet Tashgetiren: Këtu ndoshta fëmijëve duhet t'u jepet edukimi: njeriu është me atë që do.

Osman Nuri Topbash: Imam Maliku shpjegon:

"Unë isha i vogël kur mësoja përmendësh hadithet e Resulullahut, ﷺ, e babai më jepte dhurata të ndryshme për çdo hadith. Unë nga dëshira për të përfituar dhurata mezi prisja të vinte dita e nesërme e të mësoja hadithe. Më pas, mësimi përmendësh i hadithëve të Resulullahut ﷺ, m'u shndërrua në një gjë kaq të dashur sa nuk prisja më dhurata nga babai, kështu mësoja për kënaqësinë time."

Çfarë ndodhi me Imam Malikun më pas? Atij iu mbush zemra me Resululahun ﷺ. Ai nuk hipte

në kafshën e tij në Medinë sepse thoshte:

"Mos ta shkelë kafsha dheun që ka shkelur Resulullahu, ﷺ!"

Kur kishte nevojë të ndërronte abdestin, dilte jashtë Medinës. Sigurisht në kohën për të cilën po flasim qyteti i Medinës ishte shumë i vogël.

Këto që po flasim nuk janë përralla, por histori të vërteta që janë jetuar nga dijetarët tanë që përbëjnë nivele shumë të larta besimi.

Kur dikush vinte tek ai për t'i bërë ndonjë pyetje, ai menjëherë i drejtonte pyetjen:

"Do të me pyesësh në lidhje me ndonjë temë Fikhu (jurisprudence islame) apo për ndonjë hadith të nderuar?"

Nëse do të pyetej për ndonjë hadith, rregullonte çallmën, lyhej me erë të mirë, ulej diku lart e më pas ishte gati të dëgjonte pyetjen. Këtë e bënte sepse do të transmetonte ndonjë hadith që kishte dalë nga goja e nderuar e Resulullahut, ﷺ, sepse do të përmendte më të Dashurin e Allahut, ﷻ.

Vëreni tani sa njerëz pasojnë Imam Malikun... me miliona besimtarë. Ky dijetar i nderuar prej secilit prej tyre merr "sadaka-i xharije" (sadaka rrjedhëse). E çfarë është kjo? Vetëm dashuri, asgjë tjetër. A është e mundur të bëhet kjo pa dashuri? Njeriu mund të bëjë diçka, një apo dy herë pa dashuri, por pastaj mërzitet, velet dhe e braktisë atë.

Fatkeqësisht sot i jepet shumë rëndësi edukimit

të dynjasë. Ne nuk kemi për qëllim ta zhvlerësojmë atë, jo hiç fare. Por edukimit të ahiretit duhet t'i jepet më rëndësi. Çfarë bëjnë prindërit në kohët tona?

Bëhen copash që fëmijët e tyre të edukohen në kolegjin më të mirë, të kryejnë studimet në universitetin më të mirë, të dalin jashtë shteti etj..

Jemi dakort me të gjitha këto përpjekje, por fëmija a duhet të ketë edhe edukimin fetar?

Ka prej atyre që shprehen: "Unë i dërgoj fëmijët në kurset verore për të mësuar fenë."

Edukimin që sahabët morën nga Resulullahu, ﷺ, për 23 vjet, fëmija juaj do ta asimilojë për dy muaj të vetëm?! Ky nuk është asgjë tjetër veçse mashtrim i vetes.

Me të vërtetë prindërit kanë përgjegjësi dhe një barrë të rëndë detyrash ndaj fëmijëve të tyre. Fëmijët e tyre do të jenë një "sadaka-i xharije" për ta, nëse do t'i edukojnë siç duhet. Ata do të përfitojnë nga veprat e mira të fëmijëve të tyre, qoftë në jetën e varrit e qoftë në kiamet, në raport me mundin që kanë dhënë për edukimin e duhur të tyre.

Nëse fëmija neglizhohet, i shkon për shtat shumicës duke humbur në mesin e tyre, e si fije kashte shkapetet nga rrëketë e kohës, atëherë prindërit e tij janë përgjegjës para Allahut të Lartmadhëruar, kur ai të bëjë të këqija në jetën e kësaj bote.

Në të njëjtën kohë fëmijët do të ankohen para Allahut duke bërë padi për prindërit e tyre në ditën

e kiametit. Haku i prindërve nuk lahet kurrë, mirëpo haku i fëmijevë del këtu mbi hakun e prindërve, kjo sepse haku i Allahut është më i rëndësishmi. Fatkeqësisht kjo temë neglizhohet shumë në ditët tona.


Ahmet Tashgetiren: Edukimi i fëmijëve si myslimanë të bindur, vendosja e dashurisë së Resulullahut, ﷺ, në zemrën e tyre, duhet të jenë temat më të rëndësishme të ditës për çdo prind të përgjegjshëm.

Osman Nuri Topbash: Kjo duhet të jetë detyra e parë e prindërve. Sepse natyrat e pastra të fëmijëve, si ujrat e pastra të burimit, nga mosinteresimi në kohë, tërhiqen nga rrjedhat e gabuara e të ndotura, kështu atyre u shkatërrohet e ardhmja e tyre e ahiretit.

Ahmet Tashgetiren: Në vazhdën e temës rreth së cilës po flisnim, në lidhje me jetën e Resulullahut ﷺ... Po të mendojmë për njerëzit që jetuan me të e e shihnin atë me sytë e tyre, dhe që qysh nga Darul Erkami qendruan së bashku me të, mund të themi që ata e kishin më të lehtë ta përçonin besimin në jetën e tyre të përditshme. Padyshim që edhe ata kishin vështirësitë e tyre sepse besonin për herë të parë në një fe të vërtetë, pra vinin nga një besim i pavërtetë drejt një besimi të vërtetë, e kjo nuk është e thjeshtë.

Osman Nuri Topbash: Padyshim që ata lanë të pavërtetën dhe erdhën tek e vërteta.

Ahmet Tashgetiren: Nuk është e kollajtë, por



kur besoni dhe e shihni në jetë atë që besoni si të Dërguar është më e kollajtë ta mbartni në jetë misionin e besimit. Kur vimë në kohën tonë, i nderuar, kanë kaluar 1438 vjet nga ajo kohë. Nëse mund të shprehem kështu, si mund të jemi bashkë me dikë që nuk është në mesin tonë zotëri? Çfarë duhet të bëjmë që edhe ne, që nuk mund ta arrijmë dot nivelin e sahabëve, të jemi sadopak në rrugën e formimit të tyre?

Osman Nuri Topbash: Është i mundur afrimi…

Ahmet Tashgetiren: Afrimi është i mundur, por çfarë praktikash duhet të ndjekim për t'ia dalë? Çfarë edukimi, mësimi e lloj nxënieje këshilloni për këtë?

Osman Nuri Topbash: Fillimisht duhet të kemi parasysh faktin që fëmijët lindin të pastër, të aftë për të perceptuar e pranuar të vërtetën Islame. Më pas prindërit dhe shoqëria i japin një drejtim atyre. Prandaj duhet t'i fuqizojmë përpjekjet tona qysh në vitet parashkollore të fëmijëve. Secili prej nesh duhet ta konkretizojë duke e jetuar në përditshmëri jetën e Resulullahut, ﷺ.

Sot të gjitha shërbimet ndaj Islamit janë të vështira, si t'i vesh supin një makine që është në dishezë, për ta ngjitur sipër. Sigurisht që edhe shpërblimet e Allahut do të jenë shumë më të mëdha se shpërblimi i atyre që kësaj makine do t'i japin ndihmën e tyre

kur ajo të ketë arritur lart.

Resulullahu ﷺ ka thënë: *"Umeti im i ngjan shiut, që nuk i dihet se kë ka më të hajrit, fillimin apo fundin e tij."* Edhe në fillim kishte shumë vështirësi. Kishte dhunë, uri.

Kurse në ditët tona vështirësitë janë të një lloji tjetër. Sot ka programe shumë të rrezikshme televizive e interneti. Globalizmi po e bën njeriun më tokësor. Duke u zgjeruar kufijtë, me ndihmën e teknologjisë, po rritet trendi i dëshirës për t'i përngjarë jomyslimanëve. Njeriu ynë po ndahet nga thelbi i tij. Kjo është edhe sprova e kohës sonë. Ne kemi për detyrë të ruajmë veten, e më pas fëmijët tanë nga kjo erë e dëmshme.

Ahmet Tashgetiren: Ajo po na merr sytë e veshët...

Osman Nuri Topbash: Në këtë gjendje myslimanët duhet të vetëdijësohen për përgjegjësitë e tyre. Që do të thotë:

- Sikur të ishte në jetën e kësaj bote Resulullahu ﷺ çfarë do të më urdhëronte?

- Nëse Resulullahu ﷺ do të ishte i pranishëm në jetën e kësaj bote, me çfarë do të angazhohej?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve duhet t'i kërkojmë vazhdimisht.

I Dërguari i Allahut u ndante kohë shumë sahabëve Suffa. Ai ishte vazhdimisht i merakosur dhe i angazhuar për edukimin cilësor e moral të njeriut.

Kjo do të thotë që edhe ne duhet të ecim në rrugën e tij e të përpiqemi me mish e me shpirt që të edukojmë besimtarë cilësorë.

Njeriu i periudhës së injorancës nuk e pranonte ekzistencën e ahiretit. Madje mushrikët i bënë këtë propozim Resulullahut, ﷺ:

"O Muhamed, mos na i prek idhujt tanë, hiqi nga kurani ajetet që flasin për dënimin tonë, mos fol më për ahiretin, e ne do të të bindemi ty në çdo gjë."

Edhe sot përballemi me të njetën situatë. Njerëzit kanë dëshirë të heqin pjesë nga feja. "Kjo pjesë e fesë nuk është, këto praktika nuk duhet të jenë më" - shprehen ata. "Zinaja mos të ndalohet më!" - thonë disa prej tyre. Në ditët tona po përjetohet sërish periudha e injorancës. Sahabët rezistuan deri në vetëflijim ndaj çdo vështirësie, të njëjtën rezistencë duhet të paraqesim edhe ne në çdo përpjekje.

Se çfarë duhet bërë në kohën tonë, mund ta ilustrojmë me këtë shembull; Cila është detyra kryesore e nënës ndaj fëmijës? Padyshim t'i japë gji fëmijës. Mirëpo nëse aty ku po i jep fëmijës gji bie zjarr, çfarë duhet të bëjë ajo? Nëse ajo vazhdon t'i japë fëmijës gji atëherë do të digjen edhe nëna edhe fëmija. Ajo duhet të marrë një kovë e te fikë zjarrin si fillim. Prandaj themi që sot është koha e shërbimit.

Resulullahu, ﷺ, është shprehur:

"Më afër meje janë ata që kanë devocion dhe frikë-respekt ndaj Allahut të Lartmadhëruar."
(Ahmed, V, 235; Hejsemî, Mexhmau'z-Zevâid, Bejrut 1988, IX, 22)

Atëherë ka pasur vuajtje të tjera e sot ka vuajtje të tjera. Sahabët kishin vdekjen ballë për ballë. Kurse sot vuajtjet dhe vështirësitë janë më shumë shpirtërore.

Allahu i Lartmadhëruar në suren Teube ajeti 100 urdhëron:

وَالسَّابِقُونَ الْاَوَّلُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْاَنْصَارِ
وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِاِحْسَانٍ رَضِيَ اللّٰهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ
وَاَعَدَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي تَحْتَهَا الْاَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا
اَبَدًا ذٰلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

"Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!" (Teube, 100)

Nëse do t'i hidhnim një shikim të kujdesshëm ajetit, do të vërenim se në fillimin e tij përmenden muhaxhirët. Ata përjetuan vuajtjet më të tmerrshme. Më pas në radhë vijnë ensarët, ata që nuk

kursyen pasuri e katandi në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar. Në vazhdimin e ajetit përmenden ata që kanë mirësinë e përkushtimin e që pasuan rrugën e dy grupeve të para... Allahu i Lartmadhëruar dëshiron që ne të përpiqemi t'u përngjasojmë atyre.

Ahmet Tashgetiren: E sidomos në pjesën e fundit mund të hyjë gjithë umeti i Resulullahut ﷺ.

Osman Nuri Topbash: Po, mund të përfshihet i gjithë umeti.

Ahmet Tashgetiren: Sipas hadithit që cituat më sipër: "Nuk dihet se fillimi apo fundi i umetit është më i mirë", ka akoma një shans për ne. Bashkëbisedimi ynë po shkon këndshëm. Kam dëshirë t'ju drejtoj edhe një pyetje e më pas nuk dua t'ju marr më kohën.

Osman Nuri Topbash: Të lutem, mos e thuaj atë fjalë!



ÇËSHTJET QË DUHET TË KEMI KUJDES NË KOHËT TONA


Ahmet Tashgetiren: Nëse lutemi që ky mevlud të jetë fillimi i një jetë tjetër, çfarë i këshilloni lexuesit tonë në lidhje me një stil tjetër të jetuari? Kur themi: "Dua të përjetoj një lindje tjetër, një besëlidhje tjetër me Resulullahun, ﷺ.", çfarë duhet të bëjmë që ta mbërrijmë këtë gjendje e që ta mbajmë pasi ta mbërrijmë?

Osman Nuri Topbash: Kur dikush ka një gjë të çmuar në dorë, nuk ec në rrugë duke luajtur me të, por përpiqet ta ruajë atë në një vend të sigurtë. E mbron atë nga hajdutët. Në kohët tona hajdutët janë të shumtë. Ata vjedhin besimin e njerëzve. Gjëja e parë dhe më e rëndësishmja është të ruajmë imanin tonë. Prandaj Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin Famëlartë urdhëron:

يَا اَيُّهَا الَّذِينَ اٰمَنُوا اتَّقُوا اللّٰهَ وَكُونُوا مَعَ الصَّادِقِينَ

"O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)**!"** (Teube, 119)

Kurani Famëlartë ka ndjeshmëri të lartë ndaj kësaj çështjeje. Për shembull në suren Kehf për-



mendet 2-3 herë fakti që një qen ka qëndruar me besnikët në shpellë. Shejh Sadiu shprehet:

"Një qen prejse bëri rojtarin e vepërmirëve, u bë besnik dhe fitoi të drejtën të përmendet në Kuran."

Ndërsa në suren Tahrim përmenden dy gratë e profetëve të cilat duke qendruar me gjynahqarët u bënë nga banoret e xhehnemit. Këto janë fakte shumë të rëndësishme mbi të cilat duhet reflektuar.

E para gjë që duhet të bëjmë është të qëndruarit bashkë me vepërmirët dhe besnikët. Madje duhet ta formojmë rrethin tonë mbi këtë këndvështrim. Resulullahu, ﷺ, ka thënë: *"Varrosini të vdekurit tuaj afër njerëzve të mirë."* (Dejlemî, Musned, I, 102.) Kjo do të thotë që nga qendrimi me vepërmirët dhe besnikët duhet të marrim energjinë e mjaftueshme për t'u përmirësuar.

Një temë tjetër ndaj së cilës duhet të kemi kujdes në provimin e robërisë është kafshata hallall dhe kujdesi ndaj hakut të tjetrit. Sepse haku i tjetrit është shumë i rëndësishëm. Në Kuranin Famëlartë urdhërohemi:

وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ

"përveç atyre që..., i kështillojnë njëri-tjetrit të vërtetën..." (Asr, 3)

Në një tjetër ajet Allahu ﷻ urdhëron:

وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوٰى
وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْاِثْمِ وَالْعُدْوَانِ

"Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!" (Maide, 2)

Ku fillon haku i robit? Nëse mendojmë thellë ai fillon qysh në barkun e nënës. Nëna e ushqen fëmijën me ushqimet e saj, heq vuajtjet e barrës qysh se i vogli është në barkun e saj. Më pas i jep gji atij, e qumështi duhet të jetë hallall. Aty fillon edhe haku. Nga njëra anë babai që duhet të sjellë në shtëpi ushqimin hallall e nga ana tjetër nëna që shërben me plot përkushtim.

Një person erdhi tek i **Dërguari Allahut**, ﷺ, dhe e pyeti:

"-O i Dërguari i Allahut! Ndaj kujt duhet të sillemi më mirë?"

Resulullahu, ﷺ, iu përgjigj:

"-Ndaj nënës, më pas sërish ndaj nënës, sërish ndaj nënës, e mandej ndaj babait, pastaj ndaj më të afërmve, farefisit." (Muslim, Birr, 2.)

Jeta e njeriut është një poemë të drejtash e përgjegjësish që fillon nga barku i nënës e deri në varr.

T'i japësh selam vëllait tënd mysliman madje është një e drejtë e tij ndaj teje. Gjatë dhënies së

selamit ti bën dua për të. Jeta është e mbushur me të tilla të drejta. Në fund, kur ti vdes, ai që të lan dhe që të qefinos ka përgjegjësi ndaj teje. E gjithashtu edhe ai që ta fal xhenazen dhe të dërgon deri në varr po kryen një detyrë e një përgjegjësi. Resulullahu, ﷺ, kërkon nga ne që jetën ta çojmë duke respektuar të drejtat dhe përgjegjësitë tona.

Nëse do të përpiqeshim të bënim një përmbledhje të të gjithave, do të thoshim: të kujdesemi ndaj hakut dhe të drejtave të vetes dhe të të tjerëve, të qëndrojmë me vepërmirët dhe besnikët, të kujdesemi ndaj kafshatës së bukës e ushqimit që hamë, që të jetë hallall, të mos ngulim asnjë gjemb në zemrën e askujt, të gjallërojmë shpirtërat... Këto janë veprat më kryesore që do të lumturonin Resulullahun, ﷺ.

Pastaj namazi është shumë i rëndësishëm. Namazi është një temë mbi të cilën qëndron shumë edhe Kurani Famëlartë, por edhe Resulullahu, ﷺ.

اُتْلُ مَآ اُوحِيَ اِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ وَاَقِمِ الصَّلٰوةَ
اِنَّ الصَّلٰوةَ تَنْهٰى عَنِ الْفَحْشَآءِ وَالْمُنْكَرِ
وَلَذِكْرُ اللّٰهِ اَكْبَرُ وَاللّٰهُ يَعْلَمُ مَا تَصْنَعُونَ

"Lexo (o Muhamed) **atë që të është zbritur ty prej Librit** (Kuranit) **dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut**

është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni."
(Ankebut, 45)

Si duhet të falet namazi që do ta largojë njeriun nga e keqja?

Ai duhet të falet në harmoni të plotë mes zemrës dhe trupit...

Allahu i Lartmadhëruar në Kuran urdhëron:

قَدْ اَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ ﴿١﴾ اَلَّذِينَ هُمْ فِى صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ ﴿٢﴾

"Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përulur në namazin e tyre."
(Muminun, 1-2)

وَالَّذِينَ هُمْ عَلٰى صَلَوَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ

"dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet."
(Muminun, 9)

اَلَّذِينَ هُمْ عَلٰى صَلَاتِهِمْ دَآئِمُونَ

"e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre."
(Mearixh, 23)

وَاسْجُدْ وَاقْتَرِبْ

"... por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!"
(Alak, 19)

Ndërsa për atë që fal namazin në mënyrë të shkujdesur në Kuran thuhet:

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ ﴿٤﴾ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ ﴿٥﴾

"Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet." (Maun, 4-5)

Aishja ﵂ në lidhje me thellësinë e namazit të Resulullahut ﷺ ka thënë:

"Kur i Dërguari i Allahut, ﷺ, falte namazin, nga gjoksi i tij dëgjoheshin tinguj të çuditshëm, si i valimit të kazanit në zjarr. Kur këndohej ezani, nga përgjegjësia e daljes para Allahut Fuqiplotë, ai nuk njihte as ata që e rrethonin." (Ebû Dâvûd, Salât, 157; Nesâî, Sehv, 18.)

Resulullahu ﷺ i vinte shumë rëndësi faljes së namazit me xhematë nga ana e besimtarit. Kur ai ﷺ hynte në Ravza, shihte mirë se mos dikush nga xhemati nuk kishte ardhur. Kush nuk kishte ardhur e pse nuk kishte ardhur? U përpiqte t'ua zgjidhte hallet atyre që nuk kishin ardhur. Nëse ata ishin të sëmurë, u shkonte për vizitë. Nëse ata ishin udhëtarë, u bënte dua.

Enesi ﵁ na ka informuar:

"Nëse Resulullahu ﷺ nuk e shihte njërin nga vëllezërit e tij të besimit për tri ditë me radhë, pyeste për të. Nëse ai ishte larg bënte dua për të, nëse ai ishte në shtëpi i shkonte për vizitë, nëse ishte i sëmurë i shkonte për t'i uruar shërim sa më të shpejtë." (Hejsemî, II, 295.)

Besimtarët duhet të jenë si dy duart që lajnë

njëra-tjetrën. Një besimtar i vërtetë duhet ta konsiderojë vëllain e tij të fesë mbi veten. Ai duhet të mund të ndajë çdo mirësi, që i ka dhuruar Allahu me bujarinë e Tij, me çdo besimtar.

Resulullahu ﷺ ka thënë:

"Besimtari ka nevojë gjithmonë për vëllain e tij të fesë. Ashtu siç ka nevojë njëra dorë për tjetrën." (Dejlemî, Firdevs, III, 409/5251.)

Mëshira e Allahut të Lartmadhëruar zbret mbi xhematin. Këto janë rregullat Islame të shoqërisë, ndaj të cilave duhet të kemi shumë kujdes.



BESIMTARI ËSHTË PËRGJEGJËS PËR ÇDO VEND KU MBËRRIN ZEMRA

Ahmet Tashgetiren: Përgjegjësia ndaj vëllazërisë na imponon shërbimin apo jo i nderuar?

Osman Nuri Topbash: Mëshira ishte tipari dallues i Resulullahut, ﷺ. Gjatë gjithë jetës ai qëndroi pranë njerëzve me halle shumë. U bëri shoqëri atyre që kishin mbetur vetëm. Vrapoi për ndihmë drejt atyre që po mbyteshin në vorbullën e egos. Ai u bë udhëzuesi më i zgjedhur i të gjithë atyre që kishin humbur rrugën. Ai ndihej përgjegjës për të gjithë njerëzit. Ai vazhdimisht ishte i përfshirë nga dëshira e udhëzimit të të tjerëve. Ai tregoi të njëjtën mirësjellje si ndaj kryetarëve të shteteve e si ndaj robërve. Ai që afrohej pranë tij, largohej i mbushur me qetësi e lumturi prej tij.

Ndërsa kur shohim në mesin e sahabëve, dallojmë muhaxhirët dhe ensarët. Kur themi "Sa njerëz të virtytshëm që ishin ensarët!", a arrijmë të bëjmë pyetjen: "Sa jam unë sot si ensarët, sa interesohem unë për muhaxhirët e sotëm?" Është e mundur edhe sot të jemi ensarë. A përpiqemi? Ja tre milion muhaxhirë janë sot në Turqi. A mund t'u bëhemi atyre ensarë?

Shejh Sadiu na ka dhënë një këshillë shumë të vlefshme:

"Nëse të vjen një nevojtar te dera, mos e kthe atë duarbosh! Ku i dihet, Allahu mos e dhashtë, një ditë edhe ti bie në nivelin e tij e merr dyert e hallkut.


Interesohu fort për njeriun me zemër të plagosur. Ndoshta një ditë bëhesh edhe ti si ai.

Ti që nuk ke nevojë të marrësh dyert e hallkut, në shenjë falënderimi, mos i trego derën nevojtarit, mos ia var buzët, por buzëqeshi atij..."

Alepo digjet nga flakët këto ditë. Bota pragmatiste e oportuniste ndoshta nuk e ndjen e nuk e dëgjon këtë. Edhe ne duhet të bëhemi si ata e të heshtim? Për humanizmin këndoheshin këngë dikur. Tani janë fikur këngët e nuk dëgjohet asgjë. Është tharë ndërgjegjja njerëzore. Sot është domosdoshmëri që të përfaqësojmë karakterin dhe personalitetin islam. Nëse nuk do të bëjmë sot çfarë na takon të bëjmë, si mund t'i themi vetes mysliman? Cili do të ishte ndryshimi ynë me të tjerët?

Xherir ibn Abdullah na tregon një ngjarje në të cilën kishte qenë vetë dëshmitar:

"Një ditë shkuam te Resulullahu ﷺ në mëngjes heret. Kur në ato çaste nga fisi Mudar erdhi një grup njerëzish të armatosur me shpata, por në një gjendje shumë të keqe. Të ardhurit kishin veshur një kumash me vija që i ngjante lëkurës së tigrit. Kishin prerë



copat e kumashit e i kishin kaluar nga koka. Mirëpo nga varfëria pothuajse ishin lakuriq fare.

Kur Resulullahu ﷺ i pa të ardhurit në gjendje kaq kritike varfërie, u trishtua dhe i ndërroi ngjyra e fytyrës. Hyri menjëherë në shtëpinë e tij. Urdhëroi Bilalin رضي الله عنه të këndojë ezanin, urdhër të cilin Bilali e çoi menjëherë në vend. Më pas Bilali këndoi ikametin dhe Resulullahu, ﷺ u priu besimtarëve në faljen e namazit. Pastaj fjalimin e tij e filloi me ajetin kuranor:

"O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut... Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju." (Nisa, 1)

Më pas lexoi ajetin:

"O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!" (Hashr, 18)

Pastaj urdhëroi:

«-Secili nga ju të japë lëmoshë nga ari, sermi, rrobat, një masë grurë apo hurmë nga çfarë zotëron! Madje qoftë edhe një gjysëm hurme le ta japë lëmoshë!»

(Sahabëve u erdhi kaq rëndë trishtimi i Resulullahut ﷺ dhe zverdhje e fytyrës së tij sa) Njëri prej

ensarëve solli një qese aq të mbushur sa nuk e mbante dot në dorë. Të gjithë morën çfarë kishin, hynë në radhë dhe dhanë lëmoshë brenda mundësisë së tyre. Në fund vërejta se ishin bërë dy grumbuj me ushqime dhe veshmbathje. Kur i hodha një sy Resulullahut, ﷺ, vërejta se tashmë po i buzeqeshte dhe po i shëndriste si ari fytyra e tij e bukur…" (Muslim, Zekât, 69.)

Resulullahu ﷺ nuk e braktisi ndjeshmërinë e sadakasë dhe lëmoshës as në shtratin e vdekjes. Në ditën e fundit të kësaj jete ai ﷺ urdhëroi Aishen رضي الله عنها të shpërndante gjashtë-shtatë dinarët që i kishin mbetur. Menjëherë më pas e pyeti atë se çfarë ndodhi me dinarët që kishte urdhëruar të shpërndaheshin. Pasi mësoi se Aishja, رضي الله عنها, nga telashet, kishte harruar t'i shpërndante dinarët, i kërkoi ato dhe duke i mbledhur në grusht u shpreh:

"I Dërguari i Allahut, Muhamedi, nuk e sheh të arsyeshme të shkojë tek Allahu Fuqiplotë duke pasur dinarët e tij të pashpërndarë." Pasi i shpërndau ato në pesë familje të varfëra prej ensarëve, Resulullahu, ﷺ, u shpreh:

"-Ja, tani jam i qetë!..". Më pas e zuri një gjumë i lehtë. (Ahmed, VI, 104; Ibn-i Sa'd, II, 237-238.)

Pra ju më pyetët se çfarë duhet bërë apo jo?!

Ahmet Tashgetiren: Po, i nderuar!

Osman Nuri Topbash: Për shembull **Murati I**, pas ngadhënjimit të Kosovës, ra dëshmor aty. Ai i

kishte kërkuar Allahut të Lartmadhëruar të ishte vetë kurbani i këtij triumfi. Allahu ia pranoi duanë atij. Ata që erdhën pas tij dërguan në këto toka popullsi të pastër nga Anadolli për të përhapur Islamin në brendësi të Europës. **Fatihu** pasi mori Stambollin, u përpoq të merrte edhe Bosnjen. Kur ajo kaloi në duart e tij, dërgoi popullsi myslimane të pastër nga Anadolli. Bosnja u islamizua në masën njëqind përqind, kurse Shqipëria rreth nëntëdhjetë përqind. Si u bënë këta popuj mysliman? Me diturinë e folur apo me atë të jetuar?



PËRFAQËSIMI I PERSONALITETI ISLAM

Ahmet Tashgetiren: Pra kur arrijmë të kemi një mysliman cilësor që e jeton Islamin, mund të themi se ai mund të ndikojë shumë edhe të tjerët drejt përqafimit të Islamit.

Osman Nuri Topbash: Po, ai e gjallëron Islamin. Detyra jonë është ta gjallërojmë dhe ta bartim kudo personalitetin dhe karakterin islam.

Një ditë **Omeri** ﷺ, teksa po rrinte me miqtë e tij, kërkoi prej tyre të shprehnin nga një dëshirë. Një pjesë e tyre u shprehën:

"-Do të donim të kishim para sa kjo shtëpi ku jemi, e t'i harxhonim në rrugën e Allahut!"

Një pjesë tjetër thanë:

"-Ah sikur të kishim aq ar, sa kjo shtëpi të mbushej plot, e ta shpërndanim në rrugën e Allahut!"

Kurse pjesa tjetër që mbeti, u shprehën:

"-Sikur të kishim gurë të çmuar në masën e kësaj shtëpie ku po bashkëbisedojmë, e ta harxhonim në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar!"

Mirëpo Omeri ﷺ, u tha atyre:

"-Kërkoni më shumë!"

"-E çfarë të kërkojmë prej Allahut të Lartmadhëruar më shumë se kaq?!"-, u shprehën ata.

Në vazhdim të kësaj bisede, Omeri ﷺ u shpreh:

"Unë do të doja ta kisha këtë shtëpi plot me burra (të vërtetë e të përsosur në çdo aspekt) si **Ebû Ubejde ibn Xherrâh**, **Muâdh ibn Xhebel** dhe **Hudhejfetu'lJemânî**, e t'i dërgoja në vende të ndryshme për t'i bindur njerëzit në rrugën e Allahut, pra për t'i ftuar, e për t'i përmirësuar ata." (Buhârî, Târîhu's-Sagîr, I, 54.)

Zoti ynë urdhëron:

ثُمَّ لَتُسْئَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ

"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)**!"** (Tekâthur, 8)

Sa shumë mirësi na ka dhënë Allahu i Lartmadhëruar! Pa dyshim që për këto mirësi do të ketë edhe llogaridhënie. Për shumbull, ne e dimë sasinë e zekatit, "një në dyzet". Mirëpo përgjegjësia jonë nuk mbaron këtu. Ka sadaka (lëmoshë), ka infak (dhurim), e plot forma të tjera ndihme, të cilave nuk u dihet fundi. Allahu i Lartmadhëruar në Kuran urdhëron:

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتّٰى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ

وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ اللّٰهَ بِهِ عَلِيمٌ

"Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) **nga ajo** (pasuri) **që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë."** (Al'Imran, 92)

Nga ana tjetër duhet të kuptojmë mirë ajetin لَقَدْ مَنَّ اللهُ (Al'Imran, 164)

Ahmet Tashgetiren: Ju e theksoni në mënyrë të veçantë ajetin në fjalë. A mund të na e zgjeroni pak qasjen tuaj ndaj këtij ajeti, i nderuar?

Osman Nuri Topbash:

لَقَدْ مَنَّ اللهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ اِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْ
اَنْفُسِهِمْ يَتْلُوا عَلَيْهِمْ اٰيَاتِه وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ
وَالْحِكْمَةَ وَاِنْ كَانُوا مِنْ قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُبِينٍ

"Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) **e urtësinë** (diturinë e thellë fetare)**, edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar."** (Al'Imran, 164)

Ky ajet është edhe shkaku se pse unë në fillimin e bashkëbisedimit tonë u shpreha se Resulullahu, ﷺ, është mirësi shumë e madhe për ne e se duhet t'ia dimë kimetin fort.

T'ia japësh hakun mirësisë së Allahut, nuk është e thjeshtë. **Vehb ibn Kebshe** shkoi në Kinë. Nuk u

lodh, nuk përtoi. Kjo është t'i japësh hakun mirësisë së imanit.

Vëllai i **Ibn Abasit** shkoi në Semerkant. Në kohën e **Omerit** ﷺ, disa njerëz u dërguan në Dagistan. Në kohën e **Osmanit** ﷺ njerëz të tillë arritën të shkonin deri në Rusi. Shkuan në Afrikë. Në kohën e **Omer ibn Abdulazizit** u arrit depërtimi edhe në Spanjë. (Një ushtri prej 7 mijë vetash shpartalloi një ushtri prej 95 mijë vetash.)

Ukbe ibn Nafi shkoi deri në Kajravan dhe tha:

"O Zoti im! Mos të ishte ky det kaq i madh, do të vazhdoja rrugën e xhihadit në vendet në vazhdim."

Pse u bënë të gjitha këto rrugëtime? Të gjitha u bënë për t'i dhënë hakun e për t'i shprehur Allahut mirënjohjen e dhuratës së besimit...

Edhe sot çdo mysliman e ka për detyrë t'i japë hakun e ta shpreh me vepra mirënjohjen ndaj dhuratës më të madhe të dhënë nga Allahu i Lartmadhëruar, atë të të qënit umeti i Resulullahut, ﷺ. Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin e madhërishëm ka thënë:

يَا اَيُّهَا الَّذِينَ اٰمَنُوا اتَّقُوا اللّٰهَ حَقَّ تُقَاتِهٖ
وَلَا تَمُوتُنَّ اِلَّا وَاَنْتُمْ مُسْلِمُونَ

"O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i

takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!" (Âl' Imrân, 102)

Zoti ynë na urdhëron, «Mos vdisni ndryshe veçse duke qenë mysliman!».

Gjithashtu Allahu i Lartmadhëruar na kujton të vërtetën:

يَآ اَيُّهَا الَّذِينَ اٰمَنُوٓا اِنْ تَنْصُرُوا اللّٰهَ يَنْصُرْكُمْ
وَيُثَبِّتْ اَقْدَامَكُمْ

"O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja." (Muhammed, 7)

Ashtu siç kishin përgjegjësi dhe detyrime të rënda sahabët për kohën e tyre, ashtu kemi edhe ne përgjegjësi dhe detyrime të rënda për kohën tonë. Të gjitha këto janë të përfshira në hadithin që cekëm më lart: *"Umeti im është si shiu, i cili nuk dihet nëse e ka më të mirë fillimin apo fundin."* (Tirmidhî, Edeb, 81.) Në fakt ky hadith mund të jetë sihariq për ne. Këtë mundësi duhet ta vlerësojmë fort.

Ahmet Tashgetiren: T'i japësh hakun mirësisë, të dish se do të merresh në llogari për të.

Osman Nuri Topbash: Ahmet vëllai, kur dikush ju sjell një buqetë me lule për respektin dhe dashurinë që ka ndaj jush, ju me siguri e falënderoni atë. "U kujtua për mua"-, thoni me vete. Po përballë kësaj mirësie të Allahut të Lartmadhëruar, çfarë

duhet të bëjmë e sa duhet ta njohim? Sa duhet t'i jemi mirënjohës dhe falënderues Atij?

A nuk na mësohet kjo gjë në ajetin e parë të sures së parë?

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

"Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve." (Fatiha, 2)

Na duhet të jemi në gjendje të vazhdueshme falënderimi e mirënjohjeje. Kjo nuk arrihet vetëm me fjalë sigurisht, por me gjendje. Dhikri i vërtetë në fakt është dhikri i gjendjes, është kalimi në jetë i fjalëve që përsëriten. Ngulitja e tyre në zemër. Skalitja e tyre në zemër...



TË MERITOSH SELAMIN E RESULULLAHUT

Ahmet Tashgetiren: Salavatët na bëjnë të jemi bashkë me Resulullahun, ﷺ, këtë ndjesi na japin së brendshmi.

Osman Nuri Topbash: Po. I Dërguari i Allahut, ﷺ, ka thënë:


"Çdo gjë mes qiellit e tokës, përveç njerëzve dhe xhindëve të pabindur, më njohin mua si të Dërguarin e Allahut të Lartmadhëruar." (Ahmed ibn Hanbel, III, 310.)

Në një tjetër hadith të Resulullahut, ﷺ, thuhet:

"Kur dikush më dërgon mua salate dhe selame, Allahu i Lartmadhëruar ma rikthen mua shpirtin për t'ia pranuar selamin." (Ebû Dâvûd, Menâsik, 96.)

Ahmet Tashgetiren: Pra krijohet një marrëdhënie apo raport.

Osman Nuri Topbash: Padyshim krijohet një marrëdhënie. Një raport shpirtëror. Prandaj ka shumë rëndësi që të mund t'i bëjmë vetes një vend të veçantë në zemrën e Resulullahut, ﷺ.



Nëse flasim për çështjet e kësaj bote, dhe shohim për shembull çfarë bën një tregtar, vërejmë se ai flet për tregtinë e tij mëngjes e mbrëmje. "Fitova, nuk fitova; jo ndodhi kështu, jo ndodhi ashtu; kam fat, s'kam fat!"-, thotë ai. Nëna që do fort fëmijën e saj, flet vazhdimisht për të. Artisti, i dashuruar me artin e vet, flet vazhdimisht për veprat e tij.

Besimtari i cili ka shpëtuar nga indiferentizmi, flet vazhdimisht për Allahun ﷻ dhe për të Dërguarin e Tij. I thellohen ndjenjat. I hapen horizonte të reja perceptimi. Mahnitet nga arti i Tij. Jeton mes frikës dhe shpresës.

Ahmet Tashgetiren: Pra, kur e shmang indiferencën.

Osman Nuri Topbash: Aq sa mund ta shmangë... Ajo nuk shmanget dot tërësisht, por kjo mund të arrihet në masën e robërisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Allahu na e shtoftë praninë e Tij, gjithmonë!

Ahmet Tashgetiren: Amin!

Osman Nuri Topbash: Allahu i Lartmadhëruar na mundësoftë perceptimin siç duhet të festës së Mevludit! Ai na dhashtë mirësinë e shtrirjes së ditëlindjes së Profetit, ﷺ, në të gjithë jetën tonë!

Ahmet Tashgetiren: Amin!

Osman Nuri Topbash: Nëse e shtrijmë atë si festë e model në çdo moment të jetës sonë, atëherë lehtësohet shumë të jetuarit e besimit tonë,

sepse shtohet dashuria. Shpirti merr energji nga Resulullahu, ﷺ. Pikërisht këtë energji morën sahabët. Ata nuk menduan se si do të mund ta kapërcenin shkretëtirën e zjarrtë.


Halid ibn Zejd ebu Ejub el Ensariu e priti Profetin ﷺ si mysafir në shtëpinë e tij. Ai mori pjesë në luftëra dhe ngaqë dëgjoi hadithin *"Me të vërtetë Stambolli do të ngadhënjehet. Komandanti që do ta çlirojë atë, sa komandant i mirë që është... Ushtarët që do ta çlirojnë atë, sa ushtarë të mirë që janë..."* (Ahmed ibn Hanbel, IV, 335; Hakim, IV, 468/8300.), edhe pse ishte më se tetëdhjetë vjeç, shkoi dy herë në Stamboll.

Madje ajetin 195 të Sures Bekare, ai na e ka komentuar në mënyrën më të saktë.

Në ajetin në fjalë Allahu i Lartmadhëruar na urdhëron: **"...dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim..."**

Në kohën e emevive, ushtria islame për të merituar lajmin e mirë të Profetit, ﷺ, që përmendet në hadithin e mësipërm, arriti deri afër Stambollit. Në këtë ushtri ishte edhe Ebu Ejub el Ensari. Teksa bizantinët ishin duke mbrojtur murin e pasëm të tyre, njëri prej ensarëve eci trimërisht në mesin e tyre. Kur këtë ngjarje e pikasi një nga ushtarët muslimanë, i frymëzuar nga ajeti: **"...dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim..."**, i mahnitur u shpreh:

" – La ilahe il-lallah! Shiheni këtë njeri. Duke e parë me sytë e tij rrezikun, nuk ndalet!"



Pasi e dëgjoi këtë frazë Ebu Ejub el Ensari, u shpreh:

"O besimtarë! Ky ajet është shpallur në lidhje me ne, ensarët. Kur Allahu e ndihmoi të Dërguarin e Tij dhe i dha fitoren, ne i thamë: «Tani le të merremi me pasuritë tona dhe ta përmirësojmë dhe ta shtojmë atë duke e dhënë edhe me përqindje.»

Pas kësaj u shpall ajeti: **"Shpenzojeni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit."** (Bekare, 195) Qëllimi i shpalljes së ajetit në fjalë është ndalimi i habitjes pas kopshtve dhe bukurive të kësaj bote dhe braktisjes së përpjekjes në rrugën e Allahut Teala." (Shih. Ebu Davud, Xhihad, 22/2512; Tirmidhi, Tefsir, 2/2972.)

Të gjitha veprimet e besimtarit duhet të jenë më të bukurat.

Në një ajet kuranor thuhet:

وَاللّٰهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

"Allahu i do bamirësit." (Al-Imran, 134)

Ideali më i lartë i Pejgamberit ﷺ apo vepra që e gëzonte shpirtërisht më shumë atë, ishte edukimi i besimtarëve që ata të synonin ahiretin. Ai i donte shumë mekasit, i donte shumë edhe medinasit, por ai angazhohej me edukimin e një gjenerate të zgjedhur dhe për këtë arsye formoi sahabët e Sufës. Ata që e mësuan më mirë historinë e Profetit ishin

pikërisht këta sahabë sepse e mësuan duke e jetuar atë. Menjëherë e aplikuan në praktikë Sunetin e Profetit ﷺ. Për shembull, kur shpallej ndonjë ajet në lidhje me dhurimin, ata dilnin në mal, prisnin drunj dhe i sillnin në treg për shitje. Edhe pse ishin vetë nevojtarë, nuk mendon për veten, por përfitimet e tregtisë i çonin menjëherë tërësisht tek Resulullahu, ﷺ.

Ahmet Tashgetiren: Ata e kuptuan plotësisht jetën e Profetit ﷺ...

Osman Nuri Topbash: Siguristht. **Aishja** رضي الله عنها tregon: "Kur iu rëndua sëmundja Profetit ﷺ, ai pyeti: *«- A e falën namazin sahabët e mi?»*

« Jo, o i Dërguari i Allahut, po të presin ty.» -, i thamë ne.

«-Atëherë përgatisni për mua ujin.» -, tha ai.

Ne e ngrohëm ujin, ai u la. Duke u përpjekur për t'u ngritur nga shtrati, i ra të fikët. Pasi u vetëdijësua sërish pyeti: *«- A e falën namazin sahabët e mi?»*

« Jo, o i Dërguari i Allahut, po të presin ty.» -, i thamë ne.

«-Atëherë pregatitni për mua ujin.»-, tha ai.

Ne e ngrohëm ujin, ai u la. Duke u përpjekur për t'u ngritur nga shtrati, i ra të fikët. Pas pak u vetëdijësua.

Kjo ngjarje u përsërit disa herë. Ndërkohë nje-

rëzit po prisnin në mesxhid Resulullahun, ﷺ, për të falur namazin e jacisë. I Dërguari i Allahut, ﷺ, caktoi Ebu Bekrin, رضي الله عنه, për t'u prirë njerëzve në namazin e jacisë.

Ebu Bekri, رضي الله عنه, ishte burrë i ndjeshëm prandaj i tha Omerit رضي الله عنه:

«- O Omer, sikur t'u prije ti njerëzve në namaz?!» Omeri, رضي الله عنه, ia ktheu:

«- Ti e meriton më fort këtë detyrë!» Ebu Bekri, رضي الله عنه, vazhdoi t'i printe në namaz xhematit ato ditë.

Në njërën prej ditëve në vazhdim, kur Resulullahu, ﷺ, filloi të ndjehej më mirë, dy persona e ndihmuan dhe ai erdhi në namazin e drekës. (Akoma e kam parasysh momentin kur Resulullahut i hasnin këmbët në tokë nga mungesa e fuqisë!)

Ndërkohë Ebu Bekri, رضي الله عنه, po printe namazin. Kur ndjeu ardhjen e Profetit, ﷺ, ai desh të bënte një hap pas dhe t'i lironte vendin. Resulullahu, ﷺ, i bëri shenjë atij që të mos lëvizte nga vendi.

Ai erdhi dhe u ul pranë Ebu Bekrit, رضي الله عنه. Kështu u fal namazi, Ebu Bekri, رضي الله عنه, duke iu bindur Profetit, ﷺ, dhe xhemati duke ndjekur Ebu Bekrin, رضي الله عنه." (Buhari, Edhan, 51.)

Në mëngjesin e së hënës së 12 Rabijul evvel, Resulullahu, ﷺ, ndjeu një lehtësim në gjendjen e tij, mirëpo forca fizike për t'iu bashkuar xhematit, nuk i mjaftonte. Ai ngriti perden e derës së dhomës së tij dhe në atë çast vëzhgoi për herë të fundit sahabët

e tij të dashur që po falnin namazin me Ebu Bekrin, ﷺ, në krye. Buzëqeshi teksa vërejti sahabët krah më krah në rresht, si xhemat i bashkuar në namaz. Në njërën anë ai vuante nga dhimbjet e tmerrshme të sëmundjes që e kishte kapluar dhe nga ana tjetër përjetonte kënaqësinë e lënies mbrapa të një xhemati plot njerëz të mirë dhe të kryerjes me sukses të detyrës që Allahu Teala i kishte dhënë. (Buhârî, Meğâzî 83, Edhân 46, 94; Muslim, Salât 98; Nesâî, Xhenâiz 7.)



DETYRA JONË ËSHTË TA BËJMË PROFETIN TË BUZËQESHË...

Ahmet Tashgetiren: Gjatë këtyre ditëve të rëndësishme, a nuk është detyra jonë kryesore ta bëjmë Profetin ﷺ të buzëqeshë?!

Osman Nuri Topbash: Po, më e rëndësishmja... Për këtë arsye ai në Hutben e Lamtumirës u shpreh: *"Kujdes! (Duke bërë gjynahe, në mahsher) Mos ma nxini fytyrën!..."* (Ibn Maxhe, Menasik, 76.)

Mëshira dhe dhembshuria e Resulullahut, ﷺ, ndaj umetit të tij janë disa herë më të mëdha sesa mëshira dhe dhembshuria e nënës dhe babait për fëmijën e tyre. Për këtë arsye në ajetet kuranore ku përmendet Resulullahu, ﷺ, ai cilësohet si **"Rauf dhe Rrahim"**. Pra thellësia e dhembshurisë që mbart Profeti karshi umetit dhe forma sesi ai është i dhembshur, përshkruhen në ajetin kuranor:

لَقَدْ جَآءَكُمْ رَسُولٌ مِنْ اَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ
حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَؤُفٌ رَحِيمٌ

"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni

rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët." (Teube, 128)

Allahu i Lartmadhëruar, në këtë ajet na informon për moralin e lartë të Profetit në të cilin janë të shkrira dy cilësitë "Rauf dhe Rrahim".

Sa i spikatur është ky hadith që kalon tek Buhariu dhe Muslimi:

"Unë jam më i afërti i njerëzve ndaj besimtarit, në këtë dynja dhe në ahiret. Nëse dëshironi (argument në lidhje më këtë temë) lexoni ajetin: **«I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin...»** (Ahzab, 6)


Kur një besimtar (vdes) lë një pasuri, le ta marrin trashëgimtarët. Nëse ai lë borxhe apo një trashëgimtar që ka nevojë për përkujdesje, pasardhësi le të vijë tek unë (për mbrojtje dhe ndihmë) !" (Buhari, Tefsir, 33/1, Kefalet 5, Feraidh 4, 15, 25; Muslim, Feraidh 14.)

Në një tjetër hadith, Resulullahu, ﷺ, ka thënë: *"Unë dhe ai që kujdeset për jetimin, në xhenet do të jemi si këto të dy* (ai ngriti dorën dhe afroi gishtin tregues me atë të tretin)." (Buhari, Edep 24, Talak 14.)

Resulullahu, ﷺ, në një tjetër hadith ka thënë:

"Unë do të shkoj para jush në Ahiret dhe do ta përgatis atë për ju; do të dëshmoj për shërbimet tuaja në rrugën e Allahut ﷻ.

Vendi i takimit tonë do të jetë Keutheri. Unë arrij ta shoh Keutherin nga vendi ku ndodhem.



Unë nuk kam frikë se ju do t'i bëni shirk Allahut, por kam frikë se nga ambicia për dynja do të konfliktoheni më njëri-tjetrin." (Buhari, Megazi 17; Muslim, Fezail 31.)

"Kini kujdes! Unë për ju jam një burim sigurie. Kur të ndërroj jetë, në vorrin tim, unë do të thërras vazhdimisht:«Umeti im, umeti im!» deri kur t'i fryhet Surit..." (Ali el-Muttakî, Kenzu'l Ummâl, XIV, 414.)

"Jeta ime është mirësi për ju. Sa unë jam në jetë, ju flisni me mua dhe mësoni (shpalljen hyjnore e dispozitat). Edhe vdekja ime është mirësi për ju. Veprat tuaja më paraqiten mua. Kur shoh një vepër të bukur, falënderoj Allahun e Lartmadhëruar, kurse kur shoh ndonjë vepër të keqe, i kërkoj Allahut të Lartmadhëruar falje për ju." (Hejthemî, IX, 24.)

Ahmet Tashgetiren: Si duhet ta kuptojmë shprehjen e mësipërme të Resulullahut; "Mos ma nxini fytyrën!"?

Osman Nuri Topbash: Kur dikush dëshiron të kryejë ndonjë vepër të keqe, nuk e bën atë në lagjen ku jeton, por ikën larg prej syve të atyre që e njohin. Druhet se mos i vjen ndonjë fjalë e keqe prindërve e familjarëve të tij. Dita e kiametit do të jetë shumë më e zorshme. Njeriut do t'i shfaqen gjynahet e tij në prani të të gjithë njerëzve ndoshta. Kur atë ditë të na thuhet;

اِقْرَاْ كِتَابَكَ كَفٰى بِنَفْسِكَ الْيَوْمَ عَلَيْكَ حَسِيبًا

"Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!" (Isra, 14) atëherë do të flasë syri, veshi, trupi, gjymtyrët. Deri atëherë do të kemi harruar shumë gjëra, por ndaj nesh do të dëshmojnë gjymtyrët. Prandaj duhet të kemi shumë kujdes ndaj normave të sheriatit.

Duhet të kemi shumë kujdes kohën e paraagimit, gjithashtu. Allahu i Lartmadhëruar në librin e Tij thotë:

وَبِالْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ

"ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu)**."** (Dharijat, 18)

سَاجِدًا وَقَآئِمًا


"...ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë..." (Zumer, 9)

Siç e shprehëm më lart, edhe sjelljet tona duhet të jenë bashkë me të mirët dhe besnikët.

Ahmet Tashgetiren: Të qënët bashkë.

Osman Nuri Topbash: Në ditën kur mbajta ligjërimin për festën e ditëlindjes së Resulullahut, ﷺ, solla dy saksi.

Gjatë një ore mësimi u fola nxënësve për ndikimin dhe reflektimin. Ata kishin marrë dy vazo me



lule. Njërën e kishin lënë në atmosferën e këndimit të ajeteve kuranore dhe mbi të kishin shkruar fjalë të bukura. Madje vajza jonë e kishte marrë saksinë në fjalë edhe në klasë.

Ahmet Tashgetiren: Që lulja të dëgjonte leximin e Kuranit, besoj.

Osman Nuri Topbash: Po. Ndërsa një lule tjetër të së njëjtës madhësi e kishin futur në dhomën tjetër në atmosferën e muzikës pop. Mbi të kishin shkruar fjalë të këqija si xhehenem, ngatërresë... Kjo lule ishte vyshkur e kishte humbur bukurinë e saj. Më pas ata ishin ndier në faj duke menduar se i kishin bërë padrejtësi lules e e kishin sjellë edhe atë në klasë për të dëgjuar Kuran. Ajo në ditët ne vazhdim erdhi në vete, u zbukurua e u gjallërua sërish.

Kur një lule ndikohet kaq shumë, merreni me mend se çfarë ndikimi mund të ketë qenia njerëzore.

Duke qëndruar më shumë me besnikët shtohet mundësia e përmendjes së Resulullahut, ﷺ, më shpesh.



RESPEKTI NDAJ KURANIT E PËRJETËSON SHOQËRINË

Ahmet Tashgetiren: Një mesazh të fundit i nderuar me rastin e ditëlindjes së Profetit ﷺ...

Osman Nuri Topbash: Allahu i Lartmadhëruar i përjetësoi të parët tanë për shkak të respektit që ata kishin ndaj Kuranit Famëlartë. Për shembull;

Osman Gazi nuk fjeti dot në dhomën që i kishin përgatitur për arsye se aty kishte një Kuran të varur në mur, e kështu ai nuk mund t'i shtrinte këmbët pasi e perceptonte si mungesë respekti ndaj fjalës së Allahut të Lartmadhëruar gjestin në fjalë.

Orhan Gazi e shkroi emrin e Resulullahut ﷺ në monedhë.

Javuz Sulltan Selimi i solli amanetet e shenjta në Stamboll dhe emëroi 40 hafizë që t'u qëndronin pranë. Hafizët këndonin Kuran me radhë e në mënyrë të pandërprerë pranë amaneteve të shenjta.

Nga ana tjetër u ngritën shumë vakëfe për të plotësuar të gjitha nevojat e njerëzve. Vakëfet u shtrinë në të gjitha tokat tona. U prodhuan gurët e lëmoshës, e nuk dihej as ai që jepte e as ai që merrte. Nëpërmjet vakëfeve, shërbimi ndaj çdo krijese arriti në maksimumin e mundshëm.



U ngritën vakëfe për kompensimin e gjërave që thyheshin pa dashje nga shërbyesit. Vakëfet që u shërbenin kafshëve kur ata dëmtoheshin janë për t'u përmendur me krenari.

U zhvillua gjuha e fitoi ndjeshmëri më të lartë. Nuk u përdor më fjala "i çmendur" apo "i sëmurë mendor", por për ata që kishin probleme të kësaj natyre përdorej shprehja "të pamjaftueshmit e nderuar". Secili e vendosi veten në vendin e tyre dhe kështu u hapën dyert e mëshirës e të shërbimit ndaj tyre. Po kështu me mëshirë e shërbim u trajtuan jetimët, të vejat dhe të gjitha shtresat e tjera në nevojë të shoqërisë.

Politesa arriti shkallën kulminante. Në dritaret e shtëpive ku kishte ndonjë të sëmurë, vendosej një trëndafil i kuq që fëmijët të mos luanin aty afër e të mos shqetësonin të sëmurin me lojrat e tyre. E gjithashtu shitësit ambulat të mos bërtisnin për të shitur mallrat e tyre pranë këtyre shtëpive.

Kurse në ditët e sotme, hidhen fishekzjarre e kapsolla rrugë më rrugë e në mënyrë shumë të shkujdesur. E lëmë shpenzimin dhe faktin që ai është haram, por askush nuk do t'ia dijë nëse aty pranë ka ndonjë të sëmurë apo ndonjë grua shtatzënë. Të gjitha këto ishin rregulla të vendosura mirë në shoqërinë e asaj kohe. Nuk liheshin rrugët e papastra, nuk bëhej fjalë që ndokush të pështynte në rrugë. Të gjitha këto ishin manifestimet e një qytetërimi thellësisht islam.


Ahmet Tashgetiren: Një qytetërim i mbrujtur me moralin më të bukur profetik.

Osman Nuri Topbash: Çdo qytetërim e edukon individin e vet në llojin e vet. Ne te të parët tanë kemi parë formimin dhe edukimin e shoqërisë sipas dëshirës profetike në mënyrën më të mirë.

Në qendrat e banuara u ndërtuan xhamia dhe komplekse të mëdha. Kurse në zonat e tjera u hapën mesxhide që besimtarët të falnin sabahun dhe jacinë, të shijonin sexhdet dhe adhurimet me xhemat e mos të pengoheshin nga errësira e rrugëve.

Të gjitha kasidet e shkruara për nderimin e Resulullahut, ﷺ, janë rezultat i dashurisë së tejskajshme për të.

Në periudhën osmane, në xhamitë e sulltanëve zhvilloheshin derse (mësimet) në lidhje me tre libra shumë të rëndësishëm. Kjo ishte bërë traditë e patjetërsueshme. Këto libra u emërtuan në shenjë repsekti si "të çmuar". Sigurisht librat në fjalë i zhvillonin njerëzit me kompetencë. Lexohej e studiohej "Buhari Sherif". Më pas lexohej "Shifai Sherif", një vepër kjo e Kadi Ijazit që përshkruante figurën dhe jetën e Resulullahut, ﷺ, me nivel të lartë letrar. Më pas zhvillohej "Mesnevi-i Sherif", vepra e shquar e Rumiut, që përfaqëson kulmin e dashurisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe të Dërguarit të Tij. Me këta tre libra kultivohej dashuria në zemrën e besimtarëve.



Vetëm pse njëri prej muezinëve të Mesxhidi Nebevi, **Abdullah ibn Ummi Mektûm** ishte i verbër, në xhamitë Sulejmanije dhe Sulltanahmet mbahej një muezin i verbër.

Stacionet e trenave që shkonin në Medinën e ndritur u ndërtuan në pikat ku Resulullahu ﷺ dilte për luftë. Vendet ku Resulullahu ﷺ ishte ndalur dikur, u bënë pika ndalimi për trenat në fjalë. Kishte apo nuk kishte kallaballëk, treni ndalej aty, më pas vazhdonte rrugën.

Që zhurma e trenit mos të shqetësonte Ravzanë, stacioni i trenit u bë 2 km larg pikës në fjalë. Madje padishahët Osman nuk shkonin me makinë deri në Ravza. Arrinin me makinë deri në njëfarë vendi e mandej ecnin në këmbë për të vizituar Ravza-në.

Brumi i popullit tonë është pikërisht ky… Ushtarëve të vet nuk u tha ushtar, por "Mehmetçik", në kuptimin "Muhamed i vogël"…

Asnjëherë nuk ka ndodhur që një padishah ta ketë pritur e dëgjuar leximin e letrës së ardhur nga Medina e ndriçuar, ndejur, gjithmonë në shenjë respekti çoheshin në këmbë.

Kur **Sultan Abdulazizi** nga sëmundja dergjej në shtrat e u lajmërua se nga Medina e ndritur kishte ardhur një letër, kërkoi ndihmën e dy personave për t'u çuar në këmbë. E dëgjoi leximin e letrës në këmbë sepse e perceptonte letrën si të ardhur nga miqtë e Resulullahut, ﷺ, nga qytetarët e Medinës së ndritur.

Kështu ata u përjetësuan. Historia e njerëzimit nuk ka regjistruar një shtet tjetër me jetëgjatësi prej 620 vjetësh. Është Roma, por edhe ajo ka qenë e tillë me shkëputje.

Respekti dhe nderimi që ata i bënë Kuranit të Madhërishëm dhe dashuria që ata kishin për Resulullahun, ﷺ, i lartësoi ata mbi të gjithë të tjerët.

Resulullahu ﷺ është krijesa të cilën do më shumë Allahu i Lartmadhëruar. Zoti i gjithësisë do më shumë, por edhe lartëson më shumë, ata që duan më shumë më të Dashurin e Tij.

Ahmet Tashgetiren: Inshallah bëhemi të meritueshëm për atë dashuri, i nderuar!

Osman Nuri Topbash: Inshallah!

Ahmet Tashgetiren: Ju falënderojmë shumë për intervistën tuaj me kaq shumë vlerë! Me të vërtetë ndihem i mbushur me dashurinë ndaj Resulullahut, ﷺ. Inshallah bëhemi nga ata që e kultivojnë vazhdimisht këtë dashuri.

Osman Nuri Topbash: Amin, amin, amin, pafund herë amin!..

Ahmet Tashgetiren: Zoti qoftë i knaqur me ju! Gëzuar festën e Meuludit, i nderuar! Uroj e lutem gjithashtu që ky meulud të bëhet shkak për afrimin tonë me Resulullahun, ﷺ, për të jetuar jetën tonë me të dhe për të ndjerë me zemër gjatë jetës kapjen me dorën e tij, për të merituar shpresën që buron nga hadithi "Edhe fundi i umetit tim mund të jetë i mire!"

Osman Nuri Topbash: Zoti qoftë i kënaqur me ju, e ju falënderojmë shumë!

Dhëntë Zoti që të mund të përvetësojmë pjesë nga personaliteti i nderuar i Resulullahut, ﷺ!

Na dhëntë sukses në provimin e devotshmërisë dhe në lidhjen tonë me bindjen, nderimin dhe dashurinë ndaj tij!

Allahu i Lartmadhëruar na dhuroftë shefatin e të Dërguarit të Tij!

Na ringjalltë të gjithëve nën flamurin e falënderimit dhe mirënjohjes së Resulullahut ﷺ, dhe na e mundësoftë të pimë deri në ngopje në Keutherin e tij!

Amin!..



PËRMBAJTJE

Prezantim 5

Parafjalë 7

Çfarë është ditëlindjae Profetit? 13

Të rifreskojmë besëlidhjen
me të Dërguarin e Allahut 22

Kushti i vetëm i afrimit me Resulullahun
është Takvaja 29

Mendja iu bëftë kurban Resulullahut 35

Purifikimi i dashurisë 37

Përjetimi i lumturisësë përjetësisë
është i mundurvetëm me Resulullahun 43


Rruga për tek dashuria e Allahut Teala,
kalon nga dashuria për Profetin 47

Edukata e thirrjessë Resulullahut 51

A është festimi i ditëlindjes
së Resulullahut bidat? 54

Njeriu është me atë që do 60

Islami është ekspozuar
në personalitetin e Resulullahut 66



Braktisja e Sunetit shkakton dobësimin e fesë 69
Si duhet të zhvillohet lënda
e historisë së Resulullahut 76
Çështjet që duhet të kemi kujdes
në kohët tona..... 89
Besimtari është përgjegjës
për çdo vend ku mbërrin zemra 96
Përfaqësimi i personaliteti islam 101
Të meritosh selamin e Resulullahut 107
Detyra jonë është
ta bëjmë Profetin të buzëqeshë..... 114
Respekti ndaj Kuranit
e përjetëson shoqërinë 119